



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr.32 Regj.Them.
Datë Rregj.12.06.2023

Nr.32 VENDIMI
Dt.20.06.2023 VENDIMI

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtare: Blerona HASA (Relatore)
Gjyqtare: Emona MUÇI (Anëtare)
Gjyqtare: Manjola XHAXHO (Anëtare)
Gjyqtare: Esmeralda XHILI (Anëtare)
Gjyqtare: Alma KOLGJOKA (Anëtare)

me sekretare gjyqësore Ermelinda Nuraj, sot më datë 20.06.2023, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen Nr.32 Akti Dt.12.06.2023, me:

PADITËS: Subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga Z.Franci Nuri dhe Z.Blendi Himçi.

I PADITUR: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Znj.Ina Osmanaj dhe Znj.Daniela Alimehmeti.

PERSON I INTERESUAR: Subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, përfaqësuar nga Av.Maringlen Legisi.

OBJEKTI: Ndryshimin e Vendimit Nr.177, datë 08.06.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur:

- Prishjen e Vendimit të KSHZ Nr.539, datë 20.05.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në Zonën Zgjedhore Bashkia Elbasan, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023”, duke vendosur:
 - (i) Pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore Bashkia Elbasan; dhe
 - (ii) Përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë si dhe të Këshillit Bashkiak Elbasan me anë të votimit tradicional me fletë votimi fizike.

BAZA LIGJORE: Nenet 3/1, 6, paragrafi 1, i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Nenet 4, pika 1, 9, 45, 46 e vijues të Kushtetutës së Shqipërisë, Nenet 63, 64, 65, 98, 124, 126, 129, 130, 136, 139, 145 e vijues të Kodit Zgjedhor.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, zhvilluar në prani të palëve ndërgjyqëse:

- Pala paditëse kërkoi pranimin e kërkespadiisë, sipas objektit;
- Pala e paditur kërkoi rrëzimin e kërkespadiisë;
- Personi i interesuar kërkoi rrëzimin e kërkespadiisë.

KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR

referuar pretendime dhe prapësimeve të palëve ndërgjyqëse dhe akteve provuese të dorezuara në funksion të tyre:

VËREN

1. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Dekretin Nr.13864 Dt.24.10.2022, ka caktuar zhvillimin më datë 14 Maj 2023, të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

2. Koalicioni “Bashkë Fitojmë”¹ rezulton subjekt zgjedhor i regjistruar pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

3. Në datën 14.05.2023, në Republikën e Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, respektivisht në 61 bashki.

4. Zona zgjedhore Bashkia Elbasan rezulton të ketë pasur katër zona të administrimit zgjedhor (ZAZ), përkatësisht ZAZ Nr.47, ZAZ Nr.48, ZAZ Nr.49 dhe ZAZ Nr.50.

5. Komisionet e ZAZ-ve rezulton të kenë disponuar dhe përcjellë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve për kryetar të Bashkisë Elbasan, me përjashtim të KZAZ-së Nr.47, tabelës përmbledhëse të së cilës i ka munguar rezultati për Qendrat e Votimit Nr.2481/01, Nr.2432/00, Nr.2483/00, Nr.473/01 dhe Nr.2470/00.

6. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve rezulton të ketë disponuar Vendimin Nr.539 Dt.20.05.2023, që konsiston në:

“-Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të zgjedhjeve për Kryetar Bashkie dhe për Këshillin e Bashkisë Elbasan, të KZAZ nr.47, Bashkia Elbasan, sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Elbasan sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

¹ Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 178, datë 18.03.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, (BF), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin ka vendosur: l.Regjistrimin e Koalicionit “BASHKË FITOJMË” (PL-PDK-PBDNJ), “BF”, si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, me parti pjesëtare të tij si më poshtë:a) “Partia e Lirisë” (PL);b) “Partia Demokratiane e Shqipërisë” (PDK);c) “Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut” (PBDNJ).

- Shpalljen fitues të z.Gledian Llatja si Kryetar i Bashkisë Elbasan, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
- Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Elbasan, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij”.

7. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve rezulton të ketë arsytuar se:

“Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës zgjedhore si për Kryetarin dhe për Këshillin e Bashkisë Elbasan, u kontrolluan tabelat përmbledhëse të përkatësisht ZAZ nr.47, ZAZ nr.48, ZAZ nr.49 dhe ZAZ nr.50, nëse tabelat e rezultateve të ZAZ-ve të zonës përkatëse përfshijnë të gjitha tabelat e qendrave të votimit të asaj zone dhe rezultoi se:

Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-ve si për kryetarin ashtu edhe për këshillin, përfshijnë rezultatit e të gjitha tabelave të rezultateve të çdo QV-je të zonës zgjedhore, përveç rezultateve të tabelës përmbledhëse për zgjedhjen e Kryetarit dhe të Këshillit të Bashkisë për KZAZ nr.47 ku mungon rezultati për QV-të si më poshtë:

- 2481/01; 2432/00; 2483/00; 2473/01 dhe 2470/00.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me urdhrin me nr.80, datë 19.05.2023, ka urdhëruar KZAZ nr.47, Bashkia Elbasan, të plotësojë menjëherë tabelat dhe t'i ridërgojnë ato brenda 24 (njëzet e katër) orëve në KQZ.

Pas përfundimit të afatit për plotësimin e tabelave nga KZAZ nr.47, kjo e fundit nuk ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve. Në këtë rast, vepohet sipas përcaktimeve të nenit 123, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

KQZ-ja do të miratojë me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Elbasan dhe Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Elbasan, Qarku Elbasan, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit Zgjedhor”.

8. Pala paditëse e ka kundërshtuar administrativisht në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, Vendimin Nr.539 Dt.20.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nëpërmjet Kërkesës Ankimore Dt.24.05.2023, duke kërkuar:

“- Ekspertimin kompjuterik të çdo pajisjeje elektronike që është e pajisur me server për ruajtjen e të dhënave elektronike. Kjo të realizohet nga ekspertë të huaj të pavarur nga institucionet shtetërore apo Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Për këtë nevojitet që pajisjet të ruhen në kushte të përshtatshme në gjendjen aktuale me qëllim mosndërhyrjen nga personat e paautorizuar si dhe të mireruajtura nga agjentët atmosferikë.

- Krahasimin e rezultatit elektronik të zgjedhjeve me rezultatit fizik (fletëve të votimit të gjendura në kuti) për çdo qendër votimi. Për këtë kërkohet një proces sa më transparent dhe gjithëpërfshirës.

- Kqyrjen e kamerave të jashtme dhe të atyre të përdorura brenda qendrave të votimit me qëllim evidentimin e të gjithë personave të paautorizuar apo pjesë e administrates vendore dhe qëndrore në nivel specialist apo drejtuesi, që kanë qënë gjatë gjithë kohës nëpër qendra votimi,

evidentimin e mosnënshkrimit të deklaratave përkatëse për votuesit që janë shoqëruar, evidentimin e votimit nga vetë Operatorët e PEVN-ve, evidentimin e votimit të komisionerëve për llogari të votuesve.

- Krahësimin e kodeve të votuesve me listen e votuesve për cdo QV në Bashkinë Elbasan, në lidhje me pajisjen e identifikimit të votuesve (PEI).

- Rinumërimin dhe Rivlerësimin e votave në të gjitha qendrat e votimit të njësisë zgjedhore, Bashkia Elbasan dhe miratim i tabelës përmbledhëse për zonën zgjedhore Bashkia Elbasan duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave;

- Pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore Bashkia Elbasan;

- Përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar të bashkisë si dhe të Këshillit Bashkiak Elbasan me anë të votimit tradicional me fletë votimi dhe me garanci të plota për një proces të rregullt”.

9. Pala paditëse, rezulton të ketë argumentuar lidhur me sa më sipër, se:

“Duke qenë se jemi të bindur, bazuar në prova dhe fakte të pakundërshtueshme, se periudha para dhe zgjedhore u shoqërua me shkelje të ligjit, të cilat çënuan rëndë procesin zgjedhor në një masë të tillë që ndikoi drejtpërdrejtë në ndarjen e mandatit, në vijim do të parashtrojmë faktet që mbështesin këtë pretendim:

Në datën 20.05.2023, kemi marrë dijeni për Vendimin Nr.539, datë 20.05.2023 të KSHZ objekt ankimi.

Koalicioni Bashkë Fitojmë, ndër të tjera edhe nëpërmjet kandidatit tonë z.Luçiano Boçi, ka ardhur në dijeni të fakteve, indicieve dhe ka siguruar prova të mjaftueshme lidhur me problematika dhe parregullsi të procesit zgjedhor të ndodhura në Bashkinë Elbasan.

Duke mos qenë dakord me këtë vendim, për shkak se vlerësojmë se gjatë procesit zgjedhor prej të cilit ka dalë ky vendim kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë çënuar rëndë procesin zgjedhor, si dhe tërësia e shkeljeve të ligjit, të ndodhura në këtë zonë zgjedhore ka çënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që ka ndikuar në rezultatin final, siç do të provohen gjatë hetimit administrativ, po parashtrojmë këtë ankim me faktet, dispozitat ligjore dhe arsyetimin ligjor, si më poshtë;

- Kontestimet dhe problematikat e pajisjes elektronike të votimit e numërimit si dhe procesit zgjedhor në tërësi për KZAZ te 47, 48, 49, 50 Bashkia Elbasan:

Me datë 14.04.2023, si në gjithë territorin e Shqipërisë për Kryetarët e bashkive dhe për Këshillat Bashkiak.

Në KZAZ-të 47, 48, 49 dhe 50 që i përkasin bashkisë Elbasan, janë konstatuar problemet si më poshtë:

Problemi themelor i cili ka tjetërsuar në mënyrë masive votën e qytetarëve të Elbasanit, është programimi paraprak i rezultatit të zgjedhjeve vendore me anë të Pajisjes Elektronike të Votimit dhe Numërimit (PEVN). Ka raste të denoncuar pranë Shtabit Elektoral të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, si:

1.Është votuar për kandidatin tone z.Luçiano Boçi me numrin render “2” dhe fleta e votimit është printuar me numër render “1” duke shkuar për kandidatin e PS. Për këtë kemi disa raste të kostatuara dhe për njërin është faktuar në QV 2343, (Shkolla De Rada), QV 2373/1, 2377, 2358, 2477, 2423, 2483 dhe 248J/l.

2.Në rastet e votimit për kandidatin e “BF” z.Luçiano Boçi, kishte vonesa të pashpjegueshme në kohë të kryerjes së procesit të votimit elektronik nga pajisja PEVN;

3.Pranë shtabit elektoral të “BF”, kanë ardhur denoncime të panumërta nga votuesit për moskryerjen deri në fund të procesit të votimit, pasi nuk merrte komandën e dhënë nga votuesi te rubrika “printo”, pavarësisht komandës së dhënë. Në këto raste nga ana e komisionerëve dhe

operatorëve përkatës përgjigja ka qënë e njëjtë në çdo QV, duke iu thënë: largohuni se keni kryer procesin e votimit, ndërkohë që ky proces nuk kishte përfunduar, duke bërë të mundur që operatorët të përfundonin procesin e votimit sipas orientimeve politike, në rastet e mësipërme të dhëna nga drejtuesit e administrates vendore të bashkisë Elbasan, apo të drejtuesve të administrates qendrore;

4. Fakt tjetër i pakundërshtueshëm është ulja e numrit të votave për kandidatin e “BF” në mënyrë drastike, krejt të pashpjegueshme si dhe në mënyrë progresive për çdo QV, në krahasim me të gjitha proceset e votimit ndër vite në Bashkinë Elbasan. Nga një analizë krejt e thjeshtë e këtij fenomeni, jo vetëm në Elbasan, por në zonat e tjera ku pati votim elektronik pati problem në çdo QV, gjë e cila tregon që programimi i sistemit të votimit elektronik, ka dyshime të arsyeshme se ishte paracaktuar në përqindje ose me numër “klikimesh” fituesin;

5. Operatorët e caktuar në Qendrat e Votimit, pavarësisht konkurimit të qindra të rinjve, janë përzgjedhur ata të cilët ishin në kundërshtim me pikën 12 për kriteret e kësaj detyre, e cila përcakton se: “Operatori nuk duhet të jetë në marrëdhënie pune më ndonjë nga kandidatët që kandidon në zonën zgjedhore ku ndodhet qendra e votimit në të cilën je caktuar si operator teknik”. Operatorët në masë ishin edhe familjarë të punonjësve të administrates dhe të kryetarëve të organizatave të Partisë Socialiste, ose edhe vete punonjes te administrates vendore ose qendrore.

-Problem tjetër i konstatuar dhe që ka ndikuar në rezultat është shoqërimi i votuesve nga ana e Komisionerëve, Operatorëve të QV-ve, punonjësve të administrates vendore e qendrore dhe votimi është kryer në emër të tyre, fenomen i cili ka qënë masiv dhe në çdo Qendër Votimi. Kemi QV, në të cilat votimi me shoqërues, është kryer në masën 50% e pjesëmarrësve në votim.

-Edhe kur votuesi është shoqëruar për të votuar, në shumicën absolute nuk janë nënshkruar deklaratat përkatëse sipas Kodit Zgjedhor, gjë e cila është bërë me qëllimin e vetëm që nje person te shoqëronte shume votues.

-Blerja masive e votës siç u vërtetua qe ne fushate nga media ku kemi denoncuar mbledhjen e kartave te simpatizantëve te kualicionit “Bashkë Fitojme” kundrejt shumave monetare me qellim qe te mos marrë pjesë në votim.

-U vërtetua ne vidio se disa dite përpara zgjedhjeve punonjës te ASHK, shkonin shtëpi ne shtëpi per te ofruar legalizimin ne këmbim te votës. Madje ne Elbasan iu pasqyrua edhe nga kronikat televizive te mediave te ndryshme (psh Syri TV) ku te shtunën date 13 Maj dite heshtje zgjedhore, ne Elbasan ishte e hapur zyra e ASHK-se, ku shiheshin qytetare te shumte te cilet terhiqnin dokumentat e legalizimit ose certifikatat e pronesise nga ky institucion qendror (edhe pse dite pushimi zyrtar).

-Presioni i vazhdueshëm ndaj votuesve, intimidimi i tyre dhe shoqërimi në afërsi të QV-ve deri tek Komisioni i QV-së nga ana e drejtuesve dhe punonjësve të administrates vendore dhe qendrore si edhe personave të tjerë mbështetës të kandidatit të PS-së Gledian Llatja, ka qënë një fenomen që ka ndodhur gjatë gjithë procesit të votimit nga ora 07.00 deri në ora 19.00. Për këtë kemi fakte, prova dhe emra konkretë dhe nga ana jonë do ndiqet rruga ligjore deri në kallzim penal.

-Përdorja e bizneseve VIP dhe e bizneseve në përgjithësi, para dhe gjatë procesit të votimit duke iu kërkuar me detyrim votat e punonjësve të tyre, duke iu caktuar zona patronazhimi me qëllim kontrollimin dhe intimidimin e votuesve, apo duke i caktuar edhe si komisionerë ose vëzhgues ditën e zgjedhjeve, kuptohet me qëllimin e vetëm për të kontrolluar votat e votuesve të blerë.

-Mosfunksionimi deri në tre orë i pajisjeve identifikuesve, duke ndikuar në largimin e një numri të madh zgjedhësish pa votuar.

-Punonjësit e administrates kanë qënë në çdo qendër votimi. Bashkengjitur tabela përkatëse me emrat e këtyre punonjësve sipas qendrave votimi.

-Në listat përfundimtare të zgjedhësve, është bërë ndryshimi i qendrave të votimit pa asnjë arsye për një numër të madh zgjedhësish krahasuar me zgjedhjet pararendëse, është ndarë një familjeje në dy qendra votimi, pavarësisht adresës së njëjtë të banimit.

Nuk mund të lihet pa vënë në dukje që asfalti elektoral pushtoi territorin e bashkisë Elbasan, pa u kryer as edhe një procedure prokurimi publik, pa u vendosur asnjë tabelë që tregon punimet që do kryhen, nga kush financohet apo nga cili operator ekonomik do të kryhet; premtimet apo legalizimet duke u shpërndarë lejet e legalizimeve deri një ditë para ditës së zgjedhjeve; emërimet tre mujore pak ditë përpara ditës së zgjedhjeve;

Pavarësisht fakteve e rrethanave që cituam më lart, të cilat absolutisht kanë ndikimin e tyre në rezultatin e zgjedhjeve të datës 14.05.2023, ajo që ne e konsiderojmë faktorin kyç të masakrës zgjedhore dhe deformimit në mënyrë drastike dhe krejt të pashpjegueshme të rezultatit të zgjedhjeve për Elbasanin, është programimi i rezultatit të zgjedhjeve vendore me anë të Pajisjes Elektronike të Votimit dhe Numërimit (PEVN).

- Faktet, argumentat, dispozitat ligjore ku mbështetet ankimi.

Të gjitha faktet, indicet dhe provat në disponimin tonë, provojnë në mënyrë të qartë dhe të pakundërshtueshme se kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor (madje në disa raste këto shkelje përbëjnë krim zgjedhor) dhe konkretisht:

Subjekti zgjedhor dhe njëkohësisht me cilësinë e ankuesit brenda periudhës së ngushtë në dispozicion për të siguruar provat në mbështetje të pretendimeve, ka drejtuar shkresat zyrtare për të marrë informacionin e nevojshëm. Në kushtet kur informacioni i kërkuar disponohet nga institucione publike, të qeverisjes, qendrore dhe vendore është i vështirë për tu siguruar kërkojmë nga ana juaj të administroni të plotë dokumentacionin shkresor dhe filmik në fjalë duke e kërkuar drejtpërdrejt nga institucioni pranë të cilit gjendet.

Përveç shkeljeve të ligjit të konsumuara gjatë procesit në QV-të sipërcituar në këtë zonë zgjedhore janë konsumuar edhe shkelje të rënda të ligjit zgjedhor ne procesin e votimit.

Ne kemi identifikuar një seri punonjësish të administratës publike që janë përfshirë në Elbasan në ndikim dhe intimidim të zgjedhësve, si dhe kanë qene komisionere dhe vëzhgues të PS, të emëruar në kundërshtim me Kodin Zgjedhor (një pjesë e madhe në konflikt interes me kandidatin).

P.sh: Ne QV 2328 kryetare komisionit ishte Dhurata MATA, punonjëse e Bashkisë Elbasan, në kundërshtim flagrant me Kodin Zgjedhor (neni 39, pika 2 "b"). Po kështu, Klevis HUSHI dhe Ermin SHABANI vëzhgues në këtë qendër votimi, ndërkohë që janë të dy police bashkiak në Elbasan. Ne QV 2355 Eduart ÇALA, kryetar komisioni, ndërkohë që ky është punonjës në teatrin Skampa, Bashkia Elbasan. Ne QV 2351, anëtarë komisioni, Anita QIRKO dhe Uliks QIRKO, punonjës të administrates së Bashkisë. Ne QV 2352, anëtar komisioni Gëzim PAJA, punonjës i Bashkisë Elbasan. Ne vijim, i rezervojmë vetes të drejtën që të paraqesim prova shtese në lidhje me këtë natyrë shkeljeje zgjedhore, gjate shqyrtimit në KAS të ankimit.

Në pamjet tona filmike ka shumë punonjës të Bashkisë dhe institucioneve të tjera që kanë kryer shkelje të detyrimeve të Kodit Zgjedhor por edhe vepra penale të parashikuara të dënueshme si krime zgjedhore.

Në rast se hapen dhe analizohen pamjet filmike që ndodhen në QV ose ato që do tju dërgojmë ne dhe ato që kanë regjistruar serverat e QV, do të konstatohen shume individë që kanë konsumuar në mënyrë të dukshme këto element të veprave penale në fushën e krimeve zgjedhore.

Duke marrë shkas nga të dhënat e vëzhguesve dhe të numëruesve në GNV, Koalicioni Bashkë Fitojmë, kërkon marrjen e provës nga KQZ të pajisjes me regjistrimet e kamerave të procesit të numërimit në Bashkinë Elbasan. Nga verifikimi i këtyre pamjeve filmike do të rezultojë anomali apo parregullsive në kualifikimin jo të rregullt të votës, kjo sipas evidencave dhe sipas konstatimit të pamjeve filmike pasqyruar në QV-të e ZAZ.

Pra, natyra e shkeljeve të pretenduara në procesin e leximit dhe vlerësimit të votës, e bëjnë të detyrueshme këqyrjen e materialit zgjedhor me qëllim final përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar të bashkisë si dhe të Këshillit Bashkiak Elbasan me anë të votimit tradicional me fletë votimi dhe me garanci të plota për një proces të rregullt sipas standarteve të Bashkimit Europian.

Tek shkeljet ligjore nuk mund të lenë pa përmendur edhe mosrakhordimin e shifrave të fleteve të votimit të kandidatëve me ato për Këshillin Bashkiak Elbasan, ku edhe nga tabelat e miratuara nga vete KSHZ, me vendimin e tij objekt ankimi, rezultoi fare e qarte se nuk ka përputhje midis shumave totale të votave. Me konkretisht, nga njëra anë tabela përmbledhëse e votave për kandidat bashkie del në total 65.612, kurse për këshillin bashkiak, figurojnë 65.713 vota të gjendura në kutitë e votimit elektronik.

Si ka mundësi që të ketë mospërputhje shifrash lidhur me këto rast, në kushtet kur votimi ishte totalisht elektronik dhe votimi nuk mbyllet pa u votuar edhe në këshill ?

Për të përforcuar këtë qëndrim të bazuar të Koalicioni ankues, në interesin më të lartë të procesit zgjedhor që ka të bëjë me numërimin e votave të kësaj Bashkie, janë administruar tabelat përmbledhëse dhe libri i protokollit të mbledhjeve të KZAZ-se si dhe cdo dokument tjetër që vërteton pretendimet tona. Nga këto dokumente konstatohet se nga përmbajtja e vendimmarrjeve të çdo KZAZ-je rezultojnë parregullsi të shumta të cilat kanë cenuar procesin e votimit, të numërimit, të identifikimit korrekt të votës, nëpërmjet ndërhyrjeve që janë bërë me qëllim tjetërsimin e vullnetit të zgjedhësve të kësaj zone zgjedhore.

Këto veprime vijnë në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe procedural e caktuara në aktet e Komisionit Rregullator pranë KQZ dhe të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për sa i përket pasqyrimit real dhe të vërtetë të vullnetit të zgjedhësve. Kjo rrethanë përbën shkak ligjor sipas parashikimeve të nenin 160 dhe proven se vendimi që në kundërshtojmë dhe gjithë procedura e mëpasshme që përfundon me miratimin e tabelës përmbledhëse nga KQZ janë marrë në kundërshtim të hapur me ligjin.

Ankuesi kërkon nga KAS që për nevojat e hetimit administrativ, ky organ kolegjal të vendosi të administrojë si prova Librin e Protokollit të Mbledhjeve, Proces-Verbalet e Konstatimit, filmimet e kamerave të KZAZ-ve 47, 48, 49 dhe 50 objekt ankimi, tabelat e rezultatit të grupeve të numërimit për QV të e cituara në ankim, pamjet filmike të VNV-ve, Qv-ve dhe vete ZAZ-ve si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm për një hetim administrativ të plotë dhe të paanshëm, përfshirë dokumentacionin teknik dhe dokumentacionin e penetrimit të pajisjeve elektrike të votimit.

Pavarësisht dokumentacionit të sipërpërmendur, materiali zgjedhor që do të nxirret nga pamjet filmike në shumë raste krijon dhe do të krijoj dyshime të arsyeshme se vlersimi i votës nuk është bërë në mënyrë të drejtë.

Gjithashtu, Ankuesi vlerëson se transparenca në lidhje me procesin e votimit, numërimin dhe vlerësimin e votave për zonën zgjedhore Bashkia Elbasan, ka një rëndësi të madhe për besueshmërinë e procesit zgjedhor dhe për integritetin e tij, nisur nga procesi elektronik i votimit. Për sa koha Koalicioni BF nga dokumentacioni ka konstatuar parregullsi, lindi dyshime të arsyeshme se në disa qendra votimi objekt ankimi, vota nuk është vlerësuar saktë, nuk ka shkuar aty ku ishte vullneti i zgjedhësve, dhe nevojat imediate që lind për transparenca të

procesit të numërimit për këto Qendra Votimi, duhet domosdoshmërisht të bindi anëtarët e KAS të kërkojnë marrjen e provave për të vërtetuar faktet e paraqitura nga Ankuesi nëpërmjet rinumërimit dhe rivlerësimit të votave në kutitë e votimit të qendrave të votimit, Bashkia Elbasan, sipas parashtrimeve të Kërkesës Ankimore.

Në përputhje me parashikimet e nenit 136, pika 3 të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet shprehimisht se: “Kërkesa për marrjen e provave, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni, kur mbështetet nga dy anëtarë të KQZ-së dhe kur këto prova administrohen vetëm nga KQZ-ja, pranohet menjëherë pa iu nënshtruar debatit ose votimit në KQZ. Në këtë rast organi shqyrtues i Ankimit, pra KAS është i detyruar të procedojë menjëherë me marrjen dhe shqyrtimin e provave të kërkuara”, dhe në përputhje me parashikimet e nenit 138 “Këqyrja e materialit zgjedhor” të Kodit Zgjedhor, KAS me vendim të ndërmjetëm duhet të vendosi të kryeje rinumërimin dhe rivlerësimin e votave në QV-të sipas objektit të ankimit.

Për sa i përket këtyre shkeljeve, të cilat i provojmë me prova shkresore, fotografi si dhe pamjet filmike ku janë shkelur në mënyrë flagrante nenet 116, 117, 118, 119 e vijues të Kodit Zgjedhor, KQZ bazuar në material provues të rivlerësoje votat në qendrat e votimit të kërkuara më sipër. Pasi të kryhet rinumërimi dhe rivlerësimi i këtyre kutive të votimit, KQZ të hartojë dhe të miratojë tabelën përmbledhëse përfundimtare duke shfuqizuar vendimin nr.539 datë 20.05.2023 të KSHZ, lidhur me përmbledhëse të rezultatit në Bashkinë Elbasan.

- Në lidhje me pavlefshmërinë e zgjedhjeve.

Kodi Zgjedhor ka përcaktuar në mënyrë të detajuar cilat janë rastet kur zgjedhjet shpallen të pavlefshme, cili është organi kompetent dhe pasojat që sjell një vendim i tillë. Konkretisht, neni 160 parashikon se KQZ-ja i shpall zgjedhjet të pavlefshme kur tërësia e shkeljeve të ligjit mund të ketë çënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore. Një vendimmarrje e tillë, sipas neni 121, pika 1 është kompetencë ekskluzive e KAS-it. Në rast të marrjes së një vendimi për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një zonë zgjedhore, neni 161, pika 1 parashikon se KQZ-ja urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore.

Pavlefshmëria e zgjedhjeve është mjet ligjor në duart e subjekteve ankuese, i cili mundëson anulimin e votimit/rezultatit dhe përsëritjen e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi. Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si shkaqe për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve: a) shkelje të ligjit, të cilat kanë çënuar rëndë procesin zgjedhor ose tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë çënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore; b) fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose c) mosfillim i votimit apo pezullim i tij për më shumë se pesë orë. 3. Shkaqeve sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës pararendëse kanë lidhje vetëm me procesin e votimit kurse shkaqet sipas shkronjës “a” kanë lidhje me procesin në përgjithësi (përfshirë votimin dhe rezultatin e zgjedhjeve).

Kodi Zgjedhor lejon si shkak për pavlefshmërinë një tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë çënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore. Në dallim nga shkaku themelor, ky rast kërkon më shumë se sa një shkelje, me një shkallë më të ulët cënimi. Në këtë rast nuk duhet që të ketë pasur pengim/largim të zgjedhësve në masë nga votimi, detyrim të tyre që të votojnë në masë kundër vullnetit, apo tjetërsim në masë të votës së hedhur, por mjafton që ky fenomen (pengimi/largimi i zgjedhësve nga votimi, detyrimi për të votuar kundër vullnetit, apo tjetërsimi i votës) të ketë ndodhur në atë shkallë, sa të mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve. Edhe në këtë rast, kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik pse shkelja e

pretenduar është “shkelje që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve”, si dhe me provën për përmasën e ndikimit dhe lidhjen shkakësore.

Kriteri ligjor për matjen e ndikimit përcaktohet nga neni 161 i Kodit dhe është gjithmonë numerik. Sipas pikës 2 të këtij neni “ndikim në ndarjen e mandateve në zgjedhjet për kryetar të qeverisjes vendore do të konsiderohet kur numri i zgjedhësve në qendrat e shpallura të pavlefshme është më i madh se diferenca midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave të vlefshme.

Në këtë rast faktet dhe provat te cilat për pamundësi objektive nuk mundëm ti sigurojmë por ti evidentojmë qarte për tu kërkuar institucionalisht nga KQZ, përmbushin kushtin se provat ekzistojnë përpara pretendimit, nuk krijohen për shkak të tij.

Shkeljet e pretenduara, që shërbejnë si indicia për rinumërimin dhe rivlerësimin e votave në Qendrat e votimit të njësisë zgjedhore Bashkia Elbasan.

Duke marrë shkas nga të dhënat e vëzhguesve dhe të numëruesve në GNV, Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, kërkon marrjen e provës nga KQZ të pajisjeve me regjistrimet e kamerave të procesit të numërimit në Bashkinë Elbasan. Natyra e shkeljeve të pretenduara në procesin e leximit dhe vlerësimit të votës, e bëjnë të detyrueshme rinumërimin dhe rivlerësimin për ato qendra votimi, ku nga informacionet që disponojmë konstatohet qartë se vota e Kandidatit të Koalicionit është shpërdoruar dhe për pasojë nuk është vlerësuar në mënyrë korrekte nga grupet e numërimit.

Në përputhje me parashikimet e nenit 136, pika 3 të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet shprehimisht se: “Kërkesa për marrjen e provave, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni, kur mbështetet nga dy anëtarë të KQZ-së dhe kur këto prova administrohen vetëm nga KQZ-ja, pranohet menjëherë pa iu nënshtruar debatit ose votimit në KQZ. Në këtë rast organi shqyrtues i ankimit, pra KAS është i detyruar të procedojë menjëherë me marrjen dhe shqyrtimin e provave të kërkuara”, dhe në përputhje me parashikimet e nenit 138 “Këqyrja e materialit zgjedhor” të Kodit Zgjedhor. KAS me vendim të ndërmjetëm duhet të vendosi të kryejë rinumërimin dhe rivlerësimin e votave në QV-të sipas objektit të ankimit.

Për sa i përket këtyre shkeljeve, të cilat i provojmë pamjet filmike ku janë shkelur në mënyrë flagrante nenet 116, 117, 118, 119 të Kodit Zgjedhor, KQZ bazuar në material provues të rivlerësive votat në qendrat e votimit të kërkuara më sipër. Pasi te kryhet rinumërimi dhe rivlerësimi i këtyre kutive të votimit, KQZ të hartojë dhe të miratojë tabelën përmbledhëse përfundimtare duke shfuqizuar vendimin nr. 539 datë 20.05.2023 të KQZ.

Në vlerësimin tonë ka prova të mjaftueshme për të disponuar sipas objektit të kërkitimit”.

10.Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, në përfundim të shqyrtimit të ankimit, rezulton të ketë disponuar Vendimin Nr.177 Dt.08.06.2023, që konsiston në:

“- Rrëzimin e kërkesës ankimore nr.85, datë 24.05.2023, të depozituar nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

- Lënien në fuqi të vendimit nr.539, datë 20.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Elbasan, përzgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

11. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve rezulton ta ketë bazuar vendimin, në arsyetimin se:

“1. Procedura e votimit dhe ajo e numërimit të votave janë procedura transparente dhe të dokumentuara në çdo hap. Kodi Zgjedhor është kujdesur që ato të zhvillohen në sytë e përfaqësuesve të subjekteve, vëzhguesve të pavarur dhe të publikut, si dhe çdo problem, parregullsi apo shkelje e ligjit të dokumentohet në procesverbalet tip dhe librat e protokollit të komisioneve përkatëse, si dhe të filmohet nga kamerat mbikëqyrëse të procesit, me qëllim që të shërbejë si provë materiale në proceset eventuale për kundërshtimin e rezultatit apo të zgjedhjeve në tërësi.

2. Dokumentacioni që prodhohet nga administrata zgjedhore gjatë zbatimit të procedurave të votimit dhe të numërimit të votave bën pjesë në radhën e parë dhe kryesore të provave ku mund të mbështeten kërkesat ankimore me objekt ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi. Subjektet zgjedhore kanë akses mbi këtë dokumentacion, në disa raste disponojnë ipso lege kopje të tij. Nga ana tjetër, Kodi Zgjedhor u njuh palëve edhe të drejtën për të vënë në lëvizje KQZ-në për marrjen e provave “për të vërtetuar faktet, në rast se nuk ka qenë e mundur që këto prova të siguroheshin paraprakisht prej tyre, duke paraqitur njëkohësisht edhe arsyet përse nuk ka qenë i mundur sigurimi i tyre”.

3. Pika 1, e nenit 82 të K.Pr.A saktëson: “në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej tij”. Këtë detyrim e vendos edhe Kodi Zgjedhor nëpërmjet shkronjës “b” të pikës 1, të nenit 136, kur u kërkon palëve “të tregojnë faktet dhe provat, mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre”.

4. Kodi Zgjedhor kërkon në mënyrë të shprehur që pretendimet të jenë të mbështetura në prova, sepse Kodi kërkon që t’i presë rrugën e suksesit kërkimeve të pathemelta ose me ves. Kjo do të thotë, se Kodi kërkon që raporti midis pretendimit dhe provës të jetë i drejtpërdrejtë, thënë ndryshe, prova duhet të shërbejë për të mbështetur drejtpërdrejt pretendimin. Pika 4 e nenit 136 të Kodit Zgjedhor saktëson, se “KQZ-ja mund të refuzojë kërkesën e ankuesit apo të palës së interesuar për marrjen e provave, sipas shkronjës “c” të pikës 1 dhe pikës 2 të këtij neni, vetëm nëse vlerëson se prova nuk shërben për të vërtetuar faktet e pretenduara”. Nga ana tjetër, kjo do të thotë se në raportin midis provës dhe pretendimit, prova vjen e para. Provat ekzistojnë përpara pretendimit, nuk krijohen për shkak të tij.

5. Ankuesi ka kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore. Pavlefshmëria e zgjedhjeve është mjet ligjor në duart e subjekteve ankuese, i cili mundëson anulimin e votimit/rezultatit dhe përsëritjen e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimit. Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si shkaqe për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve: shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore; b) fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose c) mosfillim i votimit apo pezullim i tij për më shumë se pesë orë.

6. KAS-i e ka trajtuar gjerësisht analizën ligjore për kërkimin e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në vendimarrjen e tij për zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 (p.sh. vendimet nr.89, datë 20.05.2021, nr. 91, datë 27.05.2021, nr. 94, datë 31.05.2021, nr. 95, datë 31.05.2021 etj.) Në këto vendime, KAS-i ka arsyetuar, se neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si tipar kryesor për shkeljet e ligjit, me qëllim që ato të trajtohen si shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, peshën e

tyre dëmprurëse mbi zgjedhjet. Në këto raste dëmi mund të vijë edhe nga një shkelje e vetme, por tronditëse për zgjedhësit ose rregullshmërinë e procesit (p.sh. cënimi i integritetit të kutive të votimit - nenet 115 dhe 138 të KZ). Përgjatë zgjedhjeve mund të ndodhin parregullsi apo shkelje të shumta, të lehta ose të rënda, të cilat mund të kenë lidhje me aspekte të veçanta të procesit, por jo të gjitha mund të cilësohen “shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor”. Shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur. Votimi familjar p.sh. që është konstatuar shpesh nga misionet vëzhguese të OSBE/ODIHR-it si shkelje e procesit zgjedhor nuk është konsideruar nga ata kurrë si shkelje që shkakton pavlefshmërinë e zgjedhjeve, sepse ata nuk e kanë vëzhguar asnjëherë këtë shkelje në masën e vet kritike. Po kështu shitblerja e votës, që gjithashtu është kritikuar në një numër zgjedhjesh, nuk është vëzhguar prej tyre në masë kritike.

7. KAS-i ka vlerësuar se masa kritike është kriteri kyç në gjykimin e kërkesave për pavlefshmëri të zgjedhjeve. Masa kritike ndryshon nga një vend në tjetrin, nga një demokraci në tjetrën, sepse masa kritike varet tërësisht nga shkalla e zhvillimit demokratik. Në çdo demokraci qëllimi është zhvillimi i zgjedhjeve dhe legjitimitimi i pushtetit nga populli. Masa kritike është instrumenti që mbron zgjedhjet dhe demokracinë nga deligitimitimi

8. KAS-i ka analizuar se Kodi Zgjedhor ka përpunuar mjete ligjore mbrojtëse të ndryshme përshkelje të ndryshme. Për një pjesë prej tyre, mjete ligjor mbrojtës është gjoba administrative (shkeljet e kryera nga media, subjektet zgjedhore, përfaqësuesit e institucioneve), për një pjesë janë masat disiplinore (shkarkimi etj.), për një pjesë është ndjekja penale (shitblerja e votës, shpërdorimi i detyrës, korrupsioni aktiv dhe pasiv në zgjedhje etj.), por për asnjërën prej tyre Kodi nuk ka përcaktuar si mjet ligjor pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Kjo është arsyeja pse ekzistenca e një apo më shumë shkeljeve, qofshin këto edhe të rënda, nuk është shkak i vetëmjaftueshëm për të kërkuar pavlefshmëri. Kjo është arsyeja pse kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik, që vërteton se shkelja e pretenduar është “shkelje që çënon rëndë procesin zgjedhor”, sikurse duhet të shoqërohen edhe me provën se sa dhe si e ka cënuar ajo procesin zgjedhor. Nevoja për provueshmëri imponon edhe nevojën për të provuar lidhjen shkakësore midis shkeljes dhe pasojës së rëndë, pengimit/largimit të zgjedhësve në masë nga votimi, detyrimin të tyre që të votojnë në masë kundër vullnetit, ose tjetërsimit në masë të votës së hedhur.

9. Kodi Zgjedhor lejon si shkak për pavlefshmërinë edhe një tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore. Në dallim nga shkak themelor, ky rast kërkon më shumë se sa një shkelje, me një shkallë më të ulët cënimi. Në këtë rast nuk duhet që të ketë pasur pengim/largim të zgjedhësve në masë nga votimi, detyrim të tyre që të votojnë në masë kundër vullnetit, apo tjetërsim në masë të votes së hedhur, por mjafton që ky fenomen (pengimi/largimi i zgjedhësve nga votimi, detyrimi për të votuar kundër vullnetit, apo tjetërsimi i votës) të ketë ndodhur në atë shkallë, sa të mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve. Edhe në këtë rast, kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik pse shkelja e pretenduar është “shkelje që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve”, si dhe me provën për përmasën e ndikimit dhe lidhjen shkakësore.

10. KAS-i ka kërkuar që argumentet për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve të jenë konkrete, të faktueshme, të provueshme dhe të matshme. Këto kërkesa që burojnë nga dispozita e pikës 1 të nenit 160 të Kodit Zgjedhor janë konfirmuar edhe nga jurisprudenca kushtetuese dhe zgjedhore shqiptare. Vendimi nr.75, datë 19.04.2002 i Gjykatës Kushtetuese, i cili mund të shërbejë si bazë për të identifikuar metodologjinë për saktësimin dhe konkretizimin e termit

“shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor”, kërkon që arsyetimi juridik i KAS-it të kalojë nëpërmjet “përcaktimit të kriterëve, koncepteve bazë si dhe parimeve mbi të cilat duhet të mbështetet organi kompetent për të konkluduar lidhur me aplikimin e shkakut të përshtatshëm kushtetues”. Shkeljet që çënojnë rëndë procesin zgjedhor duhet të jenë shkelje të tilla që e bëjnë të pavlerë rezultatin e tyre, sikurse “aktet e sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën... (duhet të jenë të tilla që) e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese” për zyrtarin e lartë.

11. KAS-i, në shqyrtimin e kërkesave për pavlefshmëri është udhëhequr nga jurisprudenca e Kolegjit Zgjedhor, i cili është marrë posaçërisht me interpretimin e pikës 1 të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, sipas tekstit që është sot në fuqi, në vendimin e tij nr.45, datë 18.11.2013. Kolegji ka konfirmuar karakterin përjashtimor të rasteve të pavlefshmërisë dhe përsëritjessë zgjedhjeve. Sipas Kolegjit Zgjedhor “përsëritja e zgjedhjeve nuk mund të kryhet për çdo shkelje të evidentuar, qoftë kjo edhe lidhur me parimet e zgjedhjeve, përveçse kur provohet se shkeljet janë të tilla që kanë ndikuar në rezultatin final”. Kolegji Zgjedhor çmon se nuk mjafton që të provosh se janë kryer shkelje që kanë çenuar procesin zgjedhor për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve, por duhet të provosh se “këto shkelje të jenë në një masë të tillë sa të mund të kenë ndikuar në ndarjen e mandatit”. Gjithashtu, Kolegji ka saktësuar se pretendimi se shkelja “përbën fenomen masiv, ndaj edhe mund të ketë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve” duhet të provohet në gjykim, përndryshe ngelet në kuadrin e një hipoteze dhe nuk mund të merret për bazë nga gjykata.

12. Ankuesi pretendoi në seancë, se të paktën në 6 QV ka ndodhur tjetërsim i votës nga regjistrimi i votës në PEVN, tek depozitimi i votësfizike në kuti. Këto raste përfshinin 4 denoncime nga votues të ndryshëm (QV nr.2373/01, QV nr.2377, QV nr.2358 dhe QV nr.2477), sipas të cilave ata kishin lexuar në votën fizike të printuar emrin e kandidatit që nuk kishin votuar dhe një pretendim, se rezultati i kutive për dy QV të KZAZ-së nr.47 nuk kuadronte me rezultatin e transmetuar nga pajisja PEVN, gjë që kishte qenë objekt debati midis KZAZ-së dhe administratës së KQZ-së (QV nr.2481/01 dhe QV nr.2483). Mbi këtë bazë, ankuesi kërkoi hapjen dhe numërimin e votave fizike për këto 6 QV, me pretendimin se rezultati i numërimit të votave fizike do të dilte i ndryshëm nga ai elektronik dhe do provonte vërtetësinë e denoncimeve. KAS-i pranoi për këqyrje dhe numërim të votave fizike QV nr.2373/01, QV nr.2481/01 dhe QV nr.2483, për shkak se për QV nr.2373/01 denoncimi ishte bërë publikisht dhe ishte i vërtetueshëm, kurse për dy QV-të e tjera për shkak se pretendimi u konfirmua edhe nga administrata e KQZ-së, por me arsyetimin se debati kishte pasur lidhje jo me transmetimin e shifrave të ndryshme, por me regjistrimin e shifrës zero, të cilën sistemi e merr sa herë që nuk arrin të lexojë USB. Për tre QVtë e tjera, pretendimi ishte i paverifikueshëm. Këqyrja dhe numërimi i votave fizike për 3 QV-të u krye në seancën e datës 05.06.2023. Rezultati provoi përputhjen e plotë të numrit dhe vlerësimit të votave fizike me përmbledhësen e votimit elektronik, duke rrëzuar pretendimin e ankuesit.

13. Ankuesi pretendoi se në KZAZ-në nr.47 ishin marrë në dorëzim kutitë e 76 QV-ve në kushte parregullsie (pa vula sigurie), gjë që ishte pasqyruar edhe në librin e protokollit të KZAZ-së. Në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së u gjet vetëm shënimi se “çdo parregullsi apo mungesë është pasqyruar në procesverbalet përkatëse”. Mbi këtë bazë, KAS-i i kërkoi administratës së KQZ-së që t’i vinte në dispozicion ankuesit procesverbalet e dorëzimit të materialeve të votimit dhe numërimit elektronik nga KQV në KZAZ, për gjithë ZAZ-në. Pas marrjes së provës, në seancën e datës 05.06.2023, ankuesi ngriti pretendimin se kutitë e 30 QV-ve ishin marrë në dorëzim me parregullsi të theksuara, të specifikuar për secilën prej tyre. KAS-i i kërkoi administratës së KQZ-së që të mbante qëndrim për këtë konstatim. Në seancën e datës 07.06.2023 administrata raportoi gjendjen faktike, si vijon: - 5 kuti pa kod sigurie në kutinë e materialeve zgjedhore; - 7 kuti të rregullta; - 12 kuti të papërdorura; - 4 kuti pa kodin e sigurisë të printerit; -

1 PEVN pa kod sigurie të USB-së; - 1 QV e përfshirë në listë si me probleme, nuk ekziston në këtë ZAZ. Ankuesi kontestoi raportimin për 2 QV, për QV-në nr.2379 dhe për QV-në nr.2446. Mbi këtë bazë, KAS-i vendosi këqyrjen e materialit zgjedhor për këto dy QV. Këqyrja e jashtme e kutive konfirmoi të dhënat e procesverbalit të marrjes në dorëzim, kurse këqyrja e fletëve fizike të votimit konfirmoi rezultatin e pasqyruar në tabelën përmbledhëse. Për QV-në nr.2446 u konstatua diferencë midis numrit të zgjedhësve të prodhuar nga pajisja PEI (132 zgjedhës) me numrin e zgjedhësve të prodhuar nga përmbledhësja e pajisjes PEVN (133 zgjedhës). Administrata e KQZ-së informoi në seancë, se sipas hetimit të kryer prej saj, diferenca me shifrën 1 vinte për shkak të votimit të operatorit, pa u regjistruar nga pajisja PEI.

14. “Rregullat procedurale teknike për procesin e votimit elektronik nëpërmjet pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik në Bashkitë Vorë, Kamëz dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, që janë miratuar me vendimin e Komisionerit nr. 415, datë 26.04.2023 përcaktojnë, se si bëhet deklarimi “kuti e parregullt” ose “PEVN e parregullt”. Mungesa e kodit të sigurisë të printerit apo e kodit të sigurisë së USB-së, janë përcaktuar në këtë dokument si shkak për deklarimin “kuti e parregullt”, përkatësisht “PEVN e parregullt”. Tetë kutitë dhe 2 PEVN-të që shfaqën këtë problematikë (QV nr. 2394/01, QV nr. 2457, QV nr. 2476/01, QV nr. 2480, QV nr. 2422/01) janë marrë në dorëzim si të rregullta. Ankuesi nuk lidhi asnjë pretendim dhe asnjë kërkim me këtë fakt. Për këtë arsye, KAS-i nuk mundi të thellonte më tej hetimin, i cili do kërkonte hapjen e kutive të këtyre QV-ve dhe verifikimin e rezultatit nga votimi elektronik me rezultatin nga numërimi dhe vlerësimi i votave fizike.

15. Vendimi i Rregullatorit nr.04, datë 13.11.2020, “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë” përcakton në shkronjën “k” të pikës 10 të tij, se “votuesit duhet t’i mundësohet verifikimi dhe konfirmimi i çdo zgjedhjeje të bërë, përfshirë dhe konfirmimin e verifikimit të versionit fizik të votës, si dhe kutia të mundësojë për aq sa është e mundur, fotografimin e votës”. Ankuesi ngriti pretendimin se ky kusht teknik është anashkaluar në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023. Pajisjet nuk lejonin konfirmimin e votës fizike. Pas konfirmimit të votimit elektronik, vota printohej dhe bëhej e shikueshme në dritaren e printerit për 5 sekonda dhe pastaj binte në kuti, pa i dhënë mundësinë zgjedhësit që të anulonte në këtë fazë votimin. Ky fakt u pranua edhe nga administrata e KQZ-së dhe u justifikua me shpjegimin, se votimi për dy organe të qeverisjes vendore dhe operimi në një votim me dy vota fizike e bëri të pamundur, për pamjaftueshmëri kohore, modifikimin e nevojshëm në programimin e pajisjes.

16. Ankuesi pretendoi se operimi në kushte paligjshmërie i pajisjes ka eliminuar një nga garancitë e procesit zgjedhor, që është e drejta e zgjedhësit për të modifikuar në çdo kohë vullnetin, deri në momentin e hedhjes së votës në kutinë e votimit, si dhe ka krijuar pabarazi midis votuesve me votim elektronik dhe atyre me votim manual. Ankuesi nuk argumentoi pse kjo paligjshmëri duhet të formojë shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në gjithë zonën zgjedhore. Gjithsesi, KAS-i duhet t’a analizojë këtë fakt në kontekstin e kërimit për pavlefshmëri dhe të japë përgjigje. Në këtë analizë, KAS-i duhet të udhëhiqet nga arsyetimi i tij themelor, i trajtuar edhe në rastet e tjera, sipas të cilit shkelja duhet të analizohet në kontekstin e dëmit që i ka sjellë procesit (për më shumë shih vendimet nr.89, datë 20.05.2021, nr. 91, datë 27.05.2021, nr. 94, datë 31.05.2021, nr. 95, datë 31.05.2021 etj.) Midis shkeljes dhe pasojës që sjell ajo duhet të ketë gjithmonë një masë kritike, e cila formon kufirin ndarës midis shkeljes dhe parregullsisë, sporadike, të izoluar, të pjesshme, të përsëritur, të përhapur, të kryer pa dashje ose me qëllim dhe shkeljes që pengon/largon zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyron ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërson në masë votën e hedhur.

17. Në rastin konkret, KAS-i e sheh shkeljen kryesisht tek mospërfshirja e Rregullatorit në zgjidhjen që i është dhënë vështirësisë teknike operative. Nëse Rregullatori do të kishte qenë i përfshirë dhe do të kishte modifikuar, për këto zgjedhje, vendimin nr.04, datë 13.11.2020, atëherë palët e interesuara do të kishin patur mundësinë të ankoheshin ndaj vendimarrjes së Rregullatorit. E drejta e ankimit ndaj akteve të administratës publike është e drejtë thelbësore. Në këtë rast, palët që kanë patur një interes të ligjshëm nuk janë lejuar t'a mbrojnë interesin e tyre, por janë vënë përpara faktit të kryer.

18. Që KAS-i të vendosë pavlefshmërinë e zgjedhjeve, për shkakun e mësipërm, duhet që ankuesi të provojë se zgjedhësve u është hequr një garanci ligjore, e cila ka kondicionuar masivisht sjelljen e votuesve dhe i ka penguar masivisht në ushtrimin e lirë të vullnetit të tyre. Ankuesi duhet të provonte, se e drejta për të korrigjuar shprehjen e vullnetit, sa kohë që nuk është mbyllur procedura e votimit, është e drejtë e cila përdoret masivisht në zgjedhje, se ajo është vijë sjelljeje e votuesve shqiptarë dhe se provohet si e tillë nga statistika zgjedhore dhe numri i lartë i votave të dëmtuara, në rastet e votimit manual. Ky do ishte korrelacioni që kërkon Kodi dhe jurisprudenca zgjedhore midis shkeljes së sipërcituar dhe pasojës që çon në pavlefshmëri zgjedhjesh. Ankuesi nuk e prezantoi para KAS-it një provë të tillë, ndoshta për shkak të faktit se praktika zgjedhore shqiptare nuk ia jep këtë mundësi.

19. Pretendimi për cënim të barazisë midis votuesve me votim elektronik dhe me votim manual, për shkak të kësaj diferencë nuk formon dot shkak për pavlefshmëri zgjedhjesh. Midis votimit manual dhe atij elektronik ka dallime, të cilat vijnë për shkak të mënyrës së ndryshme të votimit. Heqja e mundësisë së anulimit të votës fizike nuk është i vetmi dallim. Për më tepër, heqja e mundësisë së anulimit është bërë për nevojat e realizimit të procesit, jo për nevoja të manipulimit të tij. Nëse nuk do ishte bërë kjo zgjidhje kompromisi, mund të mos ishte realizuar dot votimi elektronik.

20. Ankuesi paraqiti në cilësinë e provës materiale 20 materiale video, si prova të shkeljeve të pretenduara gjatë procesit të votimit në qendrat e votimit. Një pjesë prej tyre nuk mund të përdoren me cilësinë e provës, për shkak se video është me përshpejtim imazhi dhe, për këtë shkak, nuk mund të konstatohet pretendimi (provat 0606(4).mp4 dhe 0606.mp4). Prova 2425 Labinot Mal.mp4, ndonëse është me përshpejtim imazhi, provon disa raste të kryerjes së votimit familjar, të cilat lënë të kuptohet për shkelje të procedurave të votimit të asistuar. Për provat 0606(3).mp4, 5555.mp4 dhe 7777.mp4 nuk mund të konkludohet shkelja e pretenduar, për shkak se materiali nuk është i plotë. Për provën 2441.mp4 pretendohet votimi i 3 personave 2 herë. Pamjet tregojnë se vetëm njeri nga personat kryen realisht procedurën e votimit. Prova 333333.mp4 nuk vërteton pretendimin për "ndërhyrje tek flesh i PEVN". Prova 22222.mp4 provon se një person me bexhë kryen procedurën e votimit për qytetarin. Nëse është komisioner nuk i lejohet kryerja e votimit të asistuar. Nuk provohet dot, nëse është kryer protokollimi nga komisioni, apo jo. Prova Aktivistja Xhulia Çolla.mp4 provon kryerjen e votimit të asistuar në kundërshtim me procedurat në 3 raste, dy nga të cilat nga i njeiti person. Provat e tjera përmbajnë 3 raste votimi të asistuar, por për 2 prej tyre nuk mund të konkludohet nëse është kryer protokollimi, si dhe një rast kur operatorja e pajisjes PEVN kryen procedurat e votimit për 2 persona njeri pastjetrit. Pretendimet në provat e tjera kanë lidhje me pozicionimin e kamerave vëzhguese ose me pozicionimin e pajisjeve PEVN. Pretendimet evidentojnë parregullsi, por jo shkelje.

21. Ankuesi solli në vëmendje të KAS-it vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.169, datë 26.07.2002, në mbështetje të pretendimit se votimi familjar është shkak pavlefshmërie i njohur dhe pranuar nga Gjykata Kushtetues. KAS-i sjell në kujtesë faktin se Gjykata Kushtetuese atëkohë ka vepruar si gjykatë e posaçme për shqyrtimin e konflikteve zgjedhore, d.m.th. si Kolegji Zgjedhor Gjyqësor sot. Rasti i gjykuar në atë kohë mund të përdoret si ilustrim për interpretimin që i bën

KAS-i pavlefshmërisë së zgjedhjeve. Baza e gjykimit në rastin e vitit 2002 ishte shkelja e ligjit nga KQVe të me vendim dhe pranimi nga KQV-të, si votim i rregullt, i praktikës së votimit familjar në masë. Ky është rasti kur një shkelje e vetme (vendimi i kundraligjshëm i KQV-së) mund të formojë shkak të vetmjaftueshëm për pavlefshmëri. Rasti i paraqitur nga ankuesi është i ndryshëm nga rasti i gjykuar nga Gjykata Kushtetuese në vitin 2002. Ankuesi paraqiti prova për një gjysëm duzine episodesh të votimit familjar në QV-në e fshatit Labinot Mal. Prova tregonte gjithashtu një komisioner, i cili, të paktën në njerin nga këto raste, ndërhynte për të penguar veprimin e kundërligjshëm. Episodet e denoncuara në QV-të e tjera bëjnë fjalë për votim të asistuar, i cili në vetvete është votim i ligjshëm, por duhet dokumentuar sipas një procedure të caktuar. Në këtë rast, moskryerja e procedurës duhet të cilësohet ligjërisht si parregullsi në administrim.

22. KAS-i çmon se një gjysëm duzine rastesh të votimit familjar, një numër rastesh parregullsish në zbatimin e procedurës së votimit të asistuar, një numër i kufizuar shkeljesh në asistimin e më shumë se të një personi, ose në asistimin e votuesve nga komisionerët, nuk formojnë dot masë kritike për të deklaruar pavlefshmërinë e zgjedhjeve as në qendrat respektive, as në gjithë zonën zgjedhore.

23. Të gjitha shkeljet e identifikuar nga provat video janë shkelje që ndiqen individualisht në kuadër të hetimit penal (neni 327 i Kodit Penal “Shkelja e fshehtësisë së votimit”) ose të hetimit të denoncimeve me karakter administrativ. Si episode shkeljesh, në kuadër të shqyrtimit të kërkesës për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonën zgjedhore, ato nuk plotësojnë kushtin e masës kritike që kërkon neni 160 i Kodit Zgjedhor dhe jurisprudenca zgjedhore.

24. Sa i takon pretendimeve për ushtrimin e detyrës së komisionerit apo operatorit në kushtet e papajtueshmërisë, apo të përdorimit të punonjësve të administratës ditën e zgjedhjeve pranë qendrave të votimit për të intimiduar ose shoqëruar zgjedhës të caktuar, ankuesi nuk solli prova për të faktuar pretendimin, apo për të faktuar se ishin zbatuar pa sukses procedurat mbrojtëse që parashikon ligji në këto raste, sikurse nuk solli prova lidhur me masën e ndikimit të secilit prej rasteve të denoncuara në mbarëvajtjen e zgjedhjeve. Pretendimet për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve duhet të jenë konkrete, të faktueshme, të provueshme dhe të matshme. Të tilla këto pretendime nuk ishin në tërësinë e tyre.

25. Pretendimet e tjera të parashtruara në kërkesën ankimore nuk u ndoqën nga ankuesi përgjatë shqyrtimit të ankimit. Ankuesi nuk i ngriti, nuk paraqiti prova në mbështetje të tyre dhe nuk bazoi kërkitime mbi to deri në përfundim të shqyrtimit. Prandaj KAS-i nuk sheh motiv ligjor për të analizuar dhe vendosur mbi to.

26. Bazuar në këtë analizë ligjore dhe faktike, KAS-i duhet të rrëzojë kërkesën për pavlefshmërinë e zgjedhjeve për kryetar bashkie në zonën zgjedhore bashkia Elbasan, si të pa mbështetur në ligj”.

12. Koalicioni “Bashkë Fitojmë, ka investuar Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor me padi kundër Vendimit Nr.177 Dt.08.06.2023 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, duke pretenduar se:

“- Ne gjykojmë se KAS me vendimmarrjen e tij ka gabuar duke keqinterpretuar ligjin, përkatësisht dispozitat e Kodit Zgjedhor por edhe vendimet detyruese të Rregullatorit të KQZ, vendime të cilat cekin drejteperdrejte procesin zgjedhor, sigurine si dhe besueshmerine e votimit elektronik, si dhe KAS nuk ka arritur në konkluzionet e duhura lidhur me shkeljet e shumta dhe sistematike të votimit masiv familjar, votimit të asistuar në kundërshtim me ligjin, votimit në masë etj., shkelje këto që jo vetem kanë cënuar parimet dhe garancitë kushtetuese të votës vetjake, por kanë cënuar sekretin e votës në një masë të tillë sa të ndikonte drejtëpërdrejtë në rezultat.

- Të gjitha faktet, indiciet dhe provat në disponimin tonë, provojnë në mënyrë të qartë dhe të pakundërshtueshme se vendimi i Komisionerit por edhe vendimi i KAS objekt i kesaj padie, kanë ardhur në kundërshtim me kuadrin ligjor, frymen dhe gërmen e ligjit, por edhe praktiken e deritanishme te ndjekur nga Kolegji Zgjedhor.

-Në KZAZ-të 47, 48, 49 dhe 50 që i përkasin bashkisë Elbasan, janë konstatuar, problemet si më poshtë:

Problemi themelor i cili ka tjetërsuar në mënyrë masive votën e qytetarëve të Elbasanit, është programimi paraprak i rezultatit të zgjedhjeve vendore me anë të Pajisjes Elektronike të Votimit dhe Numërimit (PEVN). Në rastet e votimit për kandidatin e “BF”, kishte vonesa të pashpjegueshme në kohë të kryerjes së procesit të votimit elektronik nga pajisja PEVN;

Pranë shtabit elektorale të “BF”, kanë ardhur denoncime të panumërta nga votuesit për moskryerjen deri në fund të procesit të votimit, pasi nuk merrte komandën e dhënë nga votuesi te rubrika “printo”, pavarësisht komandës së dhënë. Kjo gjë binte në kundërshtim edhe me Vendimin e Rregullatorit datë 13.11.2020, “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë” (saktësisht pika 10, gërma “k” e këtij akti), në të cilin parashikohet se:

“Implementimi i SEMVR duhet të sigurojë që:

(...) k) Votuesit duhet t’i mundësohet verifikimi dhe konfirmimi i çdo zgjedhjeje të bërë, përfshirë dhe konfirmimin e verifikimit të versionit fizik të votës si dhe kutia të mundësojë për aq sa është e mundur, fotografimin e votës”.

Siç ne e relatuam dhe elaboruam në seancat e KAS këtë argument, mungesa gjatë këtyre zgjedhjeve e një garancie të tillë për votuesin (konfirmimi dhe verifikimi i verifikimit të versionit fizik të votës), i ka lënë zgjedhësit në kushte më të pafavorshme sigurie se vota e tyre ka shkuar ekzaktesisht aty ku ata kanë dashur të shprehin vullnetin e tyre.

Heqja e kesaj garancie shtese i ka diskriminuar zgjedhësit qe votuan ne Elbasan ne rruge elektronike nga ata qe votuan ne Tiranë apo gjetiu me fletë votimi tradicional.

Tjeter fakt qe rezultoi nga vete kqyrja e pajisjeve PEVN duke i krahasuar ato me pajisjet PEI, ishte mosdakordimet mes nr. te votave ne kutine PEVN me nr. e votuesve qe pajisja PEI kishte regjistruar. Konkretisht, nga hapja e kutive te disa QV Bashkia Elbasan, rezultoi se ne QV 2443 pati nje diference me +1 votë qe doli nga hapja e materialeve zgjedhore, nese krahasohej vota e PEVN me nr. e votuesve sipas pajisjes PEI. Gjithashtu, ne KAS per Elbasanin u konstatuan nga ana jone mbi 30 parregullsi ne procesverbale, te gjitha ne QV te KZAZ 47 Elbasan.

Ne keto kushte, pajisjet PEVN duke mos qene ne perputhje me karakteristikat teknike detyruese qe Rregullatori prane KQZ ka imponuar per te tilla votime (votimi elektronik), gjykojme se kjo shkelje ligjore ne vetvete do te mjaftonte per te shpallur pavlefshmerine e zgjedhjeve ne Elbasan dhe per t’i riperseritur ato sipas votimit klasik me flete votimi normale.

- Ka raste të denoncuar pranë Shtabit Elektorale të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, të tilla si:

1. Është votuar për kandidatin tone z.Luçiano Boçi me numrin rendor “2” dhe fleta e votimit është printuar me numër rendor “1” duke shkuar për kandidatin e PS. Për këtë kemi disa raste të kostatuara dhe për njërin është faktuar në QV 2343, (Shkolla De Rada), QV 2373/1, 2377, 2358, 2477, 2423, 2483 dhe 2481/1.

2. Në rastet e votimit për kandidatin e “BF” z.Luçiano Boçi, kishte vonesa të pashpjegueshme në kohë të kryerjes së procesit të votimit elektronik nga pajisja PEVN;

3. Pranë shtabit elektorale të “BF”, kanë ardhur denoncime të panumërta nga votuesit për moskryerjen deri në fund të procesit të votimit, pasi nuk merrte komandën e dhënë nga votuesi te

rubrika “printo”, pavarësisht komandës së dhënë. Në këto raste nga ana e komisionerëve dhe operatorëve përkatës përgjigja ka qënë e njëjtë në çdo QV, duke iu thënë: largohuni se keni kryer procesin e votimit, ndërkohë që ky proces nuk kishte përfunduar, duke bërë të mundur që operatorët të përfundonin procesin e votimit sipas orientimeve politike, në rastet e mësipërme të dhëna nga drejtuesit e administratës vendore të bashkisë Elbasan, apo të drejtuesve të administratës qendrore;

4. Fakt tjetër i pakundërshtueshëm është ulja e numrit të votave për kandidatin e “BF” në mënyrë drastike, krejt të pashpjegueshme si dhe në mënyrë progresive për çdo QV, në krahasim me të gjitha proceset e votimit ndër vitë në Bashkinë Elbasan. Nga një analizë krejt e thjeshtë e këtij fenomeni, jo vetëm në Elbasan, por në zonat e tjera ku pati votim elektronik pati problem në çdo QV, gjë e cila tregon që programimi i sistemit të votimit elektronik, ka dyshime të arsyeshme se ishte paracaktuar në përqindje ose me numër “klikimesh” fituesin;

5. Operatorët e caktuar në Qendrat e Votimit, pavarësisht konkurimit të qindra të rinjve, janë përzgjedhur ata të cilët ishin në kundërshtim me pikën 12 për kriteret e kësaj detyre, e cila përcakton se: “Operatori nuk duhet të jetë në marrëdhënie pune më ndonjë nga kandidatët që kandidon në zonën zgjedhore ku ndodhet qendra e votimit në të cilën je caktuar si operator teknik”. Operatorët në masë ishin edhe familjarë të punonjësve të administratës dhe të kryetarëve të organizatave të Partisë Socialiste, ose edhe vete punonjës të administratës vendore ose qendrore.

- Problem tjetër i konstatuar dhe që ka ndikuar në rezultat është shoqërimi i votuesve nga ana e Komisionerëve, Operatorëve të QV-ve, punonjësve të administratës vendore e qendrore dhe votimi është kryer në emër të tyre, fenomen i cili ka qënë masiv dhe në çdo Qendër Votimi. Kemi QV, në të cilat votimi me shoqërues, është kryer në masën 50% e pjesëmarrësve në votim.

- Edhe kur votuesi është shoqëruar për të votuar, në shumicën absolute nuk janë nënshkruar deklaratat përkatëse sipas Kodit Zgjedhor, gjë e cila është bërë me qëllimin e vetëm që një person të shoqëronte shumë votues.

- Blerja masive e votës siç u vërtetua që në fushatë nga media ku kemi denoncuar mbledhjen e kartave të simpatizantëve të kualicionit “Bashkë Fitojmë” kundrejt shumave monetare me qëllim që të mos marrë pjesë në votim.

- U vërtetua me video se disa ditë para zgjedhjeve punonjës të ASHK, shkonin shtëpi në shtëpi për të ofruar legalizmin në këmbim të votës. Madje në Elbasan u pasqyrua edhe nga kronikat televizive të mediave të ndryshme (Prsh. Syri TV) ku të shtunen date 13-Maj, dite heshtje zgjedhore, në Elbasan ishte e hapur zyra e ASHK-se, ku shiheshin qytetarë të shumtë të cilët terhiqnin dokumentat e legalizimit ose certifikatat e pronësive nga ky institucion qendror (edhe pse dite pushimi zyrtar).

- Presioni i vazhdueshëm ndaj votuesve, intimidimi i tyre dhe shoqërimi në afërsi të QV-ve deri tek Komisioni i QV-së nga ana e drejtuesve dhe punonjësve të administratës vendore dhe qendrore si edhe personave të tjerë mbështetës të kandidatit të PS-së Gledian Llatja, ka qënë një fenomen që ka ndodhur gjatë gjithë procesit të votimit nga ora 07.00 deri në ora 19.00. Për këtë kemi fakte, prova dhe emra konkretë dhe nga ana jonë do ndiqet rruga ligjore deri në kallzim penal.

- Përdorja e bizneseve VIP dhe e bizneseve në përgjithësi, para dhe gjatë procesit të votimit duke iu kërkuar me detyrim votat e punonjësve të tyre, duke iu caktuar zona patronazhimi me qëllim kontrollimin dhe intimidimin e votuesve, apo duke i caktuar edhe si komisionerë ose vëzhgues ditën e zgjedhjeve, kuptohet me qëllimin e vetëm për të kontrolluar votat e votuesve të blerë.

- Mosfunksionimi deri në tre orë i pajisjeve identifikuesve, duke ndikuar në largimin e një numri të madh zgjedhësish pa votuar.

- Punonjësit e administratës kanë qënë në çdo qendër votimi.

- Në listat përfundimtare të zgjedhësve, është bërë ndryshimi i qendrave të votimit pa asnjë arsye për një numër të madh zgjedhësish krahasuar me zgjedhjet pararendëse, është ndarë një familjeje në dy qendra votimi, pavarësisht adresës së njëjtë të banimit.

Nuk mund të lihet pa vënë në dukje që asfalti elektoral pushtoi territorin e bashkisë Elbasan, pa u kryer as edhe një procedurë prokurimi publik, pa u vendosur asnjë tabelë që tregon punimet që do kryehen, nga kush financohet apo nga cili operator ekonomik do të kryhet; premtimet apo legalizimet duke u shpërndarë lejet e legalizimeve deri një ditë para ditës së zgjedhjeve; emërimet tre mujore pak ditë përpara ditës së zgjedhjeve;

Pavarësisht fakteve e rrethanave që cituam më lart, të cilat absolutisht kanë ndikimin e tyre në rezultatin e zgjedhjeve të datës 14.05.2023, ajo që ne e konsiderojmë faktorin kyç të masakrës zgjedhore dhe deformimit në mënyrë drastike dhe krejt të pashpjegueshme të rezultatit të zgjedhjeve për Elbasanin, është programimi i rezultatit të zgjedhjeve vendore me anë të Pajisjes Elektronike të Votimit dhe Numërimit (PEVN).

- Të gjitha faktet, indicjet dhe provat në disponimin tonë, si materialet video te vene ne dispozicion nga vete KQZ, provojnë në mënyrë të qartë dhe të pakundërshtueshme se ne Bashkinë Elbasan kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor (madje në disa raste këto shkelje përbëjnë krim zgjedhor) dhe konkretisht:

Ne kemi identifikuar nje seri punonjesish te administrates publike qe jane perfshire ne Elbasan ne ndikim dhe intimidim te zgjedhësve, si dhe kane qene komisionerë dhe vëzhgues te PS, te emëruar ne kundërshtim me Kodin Zgjedhor (nje pjese e madhe ne konflikt interesi me kandidatin).

Ne QV 2328 kryetare komisionit ishte Dhurata MATA, punonjëse e Bashkisë Elbasan, ne kundërshtim flagrant me Kodin Zgjedhor (neni 39, pika 2 "b"). Po kështu, Klevis HUSHI dhe Ermin SHABANI vëzhgues ne këtë qendër votimi, ndërkohë qe janë te dy police bashkiak ne Elbasan. Ne QV 2355 Eduart ÇALA, kryetar komisioni, ndërkohë qe ky eshte punonjës ne teatrin Skampa, Bashkia Elbasan. Ne QV 2351, anëtarë komisioni, Anita QIRKO dhe Uliks QIRKO, punonjës te administratës se Bashkisë. Ne QV 2352, anëtar komisioni Gëzim PAJA, punonjës i Bashkisë Elbasan.

Në pamjet filmike evidentohen shumë punonjës të Bashkisë dhe institucioneve të tjera që kanë kryer shkelje të detyrimeve të Kodit Zgjedhor por edhe vepra penale të parashikura të dënueshme si krime zgjedhore. Në rast se hapen dhe analizohen pamjet filmike që ndodhen ne QV, do të konstatohen shume individë që kanë konsumuar në mënyrë të dukshem këto element të veprave penale në fushën e krimeve zgjedhore.

Duke marrë shkas nga të dhënat e vëzhguesve dhe të numëruesve në GNV, Koalicioni Bashkë Fitojmë, kërkon marrjen e provës nga KQZ të pajisjes me regjistrimet e kamerave të procesit të numërimit në Bashkinë Elbasan. Nga verifikimi i këtyre pamjeve filmike do të rezultojë anomali apo parregullsive në kualifikimin jo të rregullt të votës, kjo sipas evidencave dhe sipas konstatimit të pamjeve filmike pasqyruar në QV-të e ZAZ.

Pra, natyra e shkeljeve të pretenduara në procesin e leximit dhe vlerësimit të votës, e bëjnë të detyrueshme këqyrjen e materialit zgjedhor me qëllim final përsëritjen e zgjedhjeve zgjedhjeve për Kryetar të bashkisë si dhe të Këshillit Bashkiak Elbasan me anë të votimit tradicional me fletë votimi dhe me garanci të plota për një process të rregullt sipas standarteve të Bashkimit European.

- Tek shkeljet ligjore nuk mund te lene pa permendur edhe mos-rakordimin e shifrave te fleteve te votimit te kandidateve me ato per Keshillin Bashkiak Elbasan, ku edhe nga tabelat e miratuara nga vete KSHZ, me vendimin e tij objekt ankimi, rezulton fare e qarte se nuk ka perputhje midis shumave totale te votave. Me konkretisht, nga njera ane tabela permblesore e

votave per kandidat bashkie del ne total 65.612, kurse per keshillin bashkiak, figurojne 65.713 vota te gjendura ne kutite e votimit elektronike. Si ka mundesi qe te kete mosperputhje shifrash lidhur me kete rast, ne kushtet kur votimi ishte totalisht elektronik dhe votimi nuk mbyllet pa u votuar edhe ne keshill? Pavaresisht se ne nje moment te dyte KQZ arriti te merrte vendim per te rakorduar shifrat, serish kjo ngjall shume pikepyetje lidhur me besueshmerine e procesitte votimit elektronik ne Elbasan.

-Për të përforcuar këtë qëndrim të bazuar të Koalicioni ankues, në interesin më të lartë të procesit zgjedhor që ka të bëjë me numërimin e votave të kësaj Bashkie, janë administruar tabelat përmbledhëse dhe libri i protokollit të mbledhjeve të KZAZ-se si dhe cdo dokument tjetër që vërteton pretendimet tona. Nga këto dokumente konstatohet se nga përmbajtja e vendimmarrjeve të çdo KZAZ-je rezultojnë parregullsi të shumta të cilat kanë cenuar procesin e votimit, të numërimit, të identifikimit korrekt të votës, nëpërmjet ndërhyrjeve që janë bërë me qëllim tjetërsimin e vullnetit të zgjedhësve të kësaj zone zgjedhore.

-Këto veprime vijnë në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe procedurat e caktuara në aktet e Komisionit Rregullator pranë KQZ dhe të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për sa i përket pasqyrimin real dhe të vërtetë të vullnetit të zgjedhësve. Kjo rrethanë përbën shkak ligjor sipas parashikimeve të nenin 160 dhe provon se vendimi që ne kundërshtojmë dhe gjithë procedura e mëpasshme që përfundon me miratimin e tabelës përmbledhëse nga KQZ janë marrë në kundërshtim të hapur me ligjin.

-Pavarësisht dokumentacionit të sipërpërmendur, materiali zgjedhor që do të nxirret nga pamjet filmike në shumë raste krijon dhe do të krijoj dyshime të arsyeshme se vlerësimi i votës nuk është bërë në mënyrë të drejtë.

- Kodi Zgjedhor ka përcaktuar në mënyrë të detajuar cilat janë rastet kur zgjedhjet shpallen të pavlefshme, cili është organi kompetent dhe pasojat që sjell një vendim i tillë. Konkretisht, neni 160 parashikon se KQZ-ja i shpall zgjedhjet të pavlefshme kur tërësia e shkeljeve të ligjit mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore. Një vendimmarrje e tillë, sipas nenin 121, pika 1 është kompetencë ekskluzive e KAS-it. Në rast të marrjes së një vendimi për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një zonë zgjedhore, neni 161, pika 1 parashikon se KQZ-ja urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore.

- Pavlefshmëria e zgjedhjeve është mjet ligjor në duart e subjekteve ankuese, i cili mundëson anulimin e votimit/rezultatit dhe përsëritjen e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi. Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si shkaqe për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve: a) shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore; b) fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose c) mosfillim i votimit apo pezullim i tij për më shumë se pesë orë. 3. Shkaqet sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës pararendëse kanë lidhje vetëm me procesin e votimit, kurse shkaqet sipas shkronjës “a” kanë lidhje me procesin në përgjithësi (përfshirë votimin dhe rezultatit e zgjedhjeve).

- Kodi Zgjedhor lejon si shkak për pavlefshmërinë një tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore. Në dallim nga shkak themelor, ky rast kërkon më shumë se sa një shkelje, me një shkallë më të ulët cënimi. Në këtë rast nuk duhet që të ketë pasur pengim/largim të zgjedhësve në masë nga votimi, detyrim të tyre që të votojnë në masë kundër vullnetit, apo tjetërsim në masë të votës së hedhur, por mjafton që ky fenomen (pengimi/largimi i zgjedhësve nga votimi, detyrimi për të votuar kundër vullnetit, apo tjetërsimi i votës) të ketë ndodhur në atë shkallë, sa të

mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve. Edhe në këtë rast, kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik pse shkelja e pretenduar është “shkelje që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve”, si dhe me provën për përmasën e ndikimit dhe lidhjen shkakësore.

-Kriteri ligjor për matjen e ndikimit përcaktohet nga neni 161 i Kodit dhe është gjithmonë numerik. Sipas pikës 2 të këtij neni “ndikim në ndarjen e mandateve në zgjedhjet për kryetar të qeverisjes vendore do të konsiderohet kur numri i zgjedhësve në qendrat e shpallura të pavlefshme është më i madh se diferenca midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave të vlefshme.

-Kriteri ligjor për matjen e ndikimit përcaktohet nga neni 161 i Kodit dhe është gjithmonë numerik. Sipas pikës 2 të këtij neni “ndikim në ndarjen e mandateve në zgjedhjet për kryetar të qeverisjes vendore do të konsiderohet kur numri i zgjedhësve në qendrat e shpallura të pavlefshme është më i madh se diferenca midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave të vlefshme.

-Në rast se hapen dhe analizohen pamjet filmike që do tju dërgojmë ne dhe ato që kanë rregjistruar serverat e QV do të konstatohen shume individ që kanë konsumuar në mënyrë të dukshme këto element të veprave penale në fushën e krimeve zgjedhore.

-1) Eshte shkelur parimi kushtetues i Votes Vetiake, i Sekretit dhe i Lirise se Votes

Me Vendim nr.169, datë 26.07.2002 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen me kërkues Gafur Muka, Partia Konservatore e Shqipërisë, me objekt: “Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.93, datë 10.07.2002 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.

- Kjo Gjykatë konstatoi se në një shumicë rastesh dhe në mënyrë të dukshme kishte votuar një person edhe për anëtarët e tjerë të familjes. Sipas GJK, “Votimi i një personi për të tjerët cënon parimin e votës vetiake, parashikuar në nenin 45/4 të Kushtetutës”. Si Kushtetuta edhe nenet e Kodit Zgjedhor, mbajnë qëndrim rigoroz kundër çdo shkelje të këtij parimi dhe përcaktojnë rregulla të detajuara për të shmangur cënimin e kësaj të drejte politike. Çdo shmangie prej tyre të çon në pasoja për gjithë procesin zgjedhor. Nga gjykimi i çështjes rezultoi se komisionet e lartpërmendura të qendrave të votimit, në kundërshtim me ligjin, kanë lejuar që zgjedhësit të votojnë në emër të familjarëve të tyre. Jo vetëm kaq, por Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka mbajtur qëndrim ndaj kësaj shkelje të rëndë të ligjit. Duke marrë parasysh shkeljet e mësipërme në atë zonë që kanë ndikuar në fitimin e mandatit GJK ka vendosur të shpalle të pavlefshme zgjedhjet në ato qendra votimi dhe të perserise zgjedhjet aty.

Ky eshte nje standard i vendosur nga Gjykata Kushtetuese dhe qe duhet te zbatohet kurdohere. Ky standard eshte gjithashtu ne perputhje edhe me rekomandimet e OSBE-ODIHR.

E njejta situatë paligjshmerie ka ndodhur edhe në Elbasan në 14-Maj 2023. Nga provat që kemi arritur të sigurojme deri tani nepermjet kqyrjes se kamerave te vete QV (vene ne dispozicion nga KQZ), evidentohet qarte raste te panumerta te shkeljes se parimit kushtetues te votes vetjake, nepermjet votimit familjar dhe prezences te nje vezhguesi / asistenti qe shpesh here duhet qarte se prek ekranin e votimit elektronik, cka do te thote se ai jo vetem mund te kete votuar ne vend te zgjedhesit, por me e pakta, ka cenuar sekretin / fshehtesine e votes si dhe ka ndikuar ne cenimin e lirise se votes:

Konkretisht keto shkelje evidentohen nepermjet prezences se dy apo me shume personave njeheresh pas ekrameve elektronike te votimit. Gjithashtu, evidentohen nga veprime te kundraligjshme dhe sistematike ne mjaft qendra votimi nga vezhgues apo asitentet e votimit elektronik, te cilet kane ndikuar zgjedhjesit sistematikisht, duke cenuar parimin e votes vetjake, parimin e sekretit te votes, si dhe gjithashtu parimin e lirise se votes pikerisht sepse duke u sjelle

ne ate menyre, veshur me autoritetin e perfaqesuesve te KQZ, ata kane dhene pershtypjen se kishin autoritetin e Shtetit dhe se i tille duhet te ishte procesi i votimit. Kemi raste pafund njerezish qe nga kamerat shihen se presin te vije "asistenti" per t'i orientuar drejt votes, nderkohe qe Kodi Zgjedhor ne nenet 106, 107 dhe 108 te tij parashikon mekanizma mjaft strik per perjashtimin nga rregulli i votes vetjake:

- Sipas ketyre dispozitave te Kodit Zgjedhor, (Neni 106, pika 3), sanksionohet se: "Zgjedhesi voton vetem per vete, me perjashtim te rastit te percaktuar ne Nenin 108 te ketij Kodi". Nderkohe Kodi Zgjedhor ne piken 5 te Nenit 106 ka nje dispozite e cila sanksionon rende shkeljet e ketij parimi: Konkretisht Kodi Zgjedhor parashikon se: "Anetaret e KQV-se, qe kane lejuar nje zgjedhes te votoje me shume se nje here ose ne emer te zgjedhesve te tjere, mbajne pergjegjesi penale, ne perputhje me Nenin 248 te Kodit Penal, (shperdorimi i detyres), me perjashtim te rastit te parashikuar nga Neni 108 i ketij Kodi". Nderkohe qe ne Kamez ne kemi arritur te provojme pa asnje medyshje se ka ndodhur votim masiv apo votim familjar ne dhjetra e qindra raste ne 14-Maj 2023 dhe askush nuk eshte perballur deri me tani me pergjegjesi ligjore apo penale nga ana e institucioneve ligzbatuese.

-2) Shkelja e procedurave garantiste të Kodit Zgjedhor ka qene sistematike dhe e qellimshme.

Kjo ka krijuar nje model sjellje ne QV qe e shtyn zgjedhesin te mendoje para se te votoje qe komisioni, pra Shteti, mund te interferoje pa kufizim ne procesin e votimit ne fshehtesi, e per rrjedhoje, te interferoje me lirine e zgjedhjes. Pra jo vetem eshte cenuar rende parimi kushtetues i sekretit dhe lirise se votes kur ka nderhyre operatori por qe i tere procesi i votimit ne QV perkatese eshte komprometuar rende, duke mos dhene jo vetem ne substance, por edhe ne dukje, garancite kushtetuese dhe ligjore zgjedhesve qe paraqiteshin per te votuar. Ne keto kushte, vullneti i zgjedhesve deformohet.

Neni 108 i Kodit Zgjedhor "Zgjedhesit qe nuk mund te votojne vete", parashikon se vetem ata zgjedhes qe per arsye fizike nuk jane ne gjendje te kryejne vete procedurat e votimit, mund te kerkojne ndihmen e nje familjari ose zgjedhesi tjetër, qe eshte ne listen e zgjedhesve te asaj vote. Gjithashtu, garancia qe kerkohet eshte perpara votimit, duhet detyrimisht qe personi te kete nenshkruar deklaraten ne Librin e Protokollit te Mbledhjeve te KQV-e perkatese si dhe te angazhohet se nuk do te beje publike voten. Merrini ju si KAS protokollin e mbledhjeve e te gjitha QV ne Kamez mbi bazen e Nenit 21 te Kodit Zgjedhor dhe do te shihni se aty nuk ka thujse asnje rast ku te jete shenuar Deklarata ne fjale ne asnje QV te Bashkise Elbasan.

Nderkohe, Neni 108 pika 4 ndalon shprehimisht qe anetaret e komisionet te zgjedhjeve apo sekretaret nuk mund te ndihmojne asnje zgjedhes qe nuk mund te votoje vete. Nga pamjet filmike kemi sjelle prova se ne dhjetra raste kane qene vete anetaret e Komisioneve te QV ata te cilet, jane ngritur e kane shkuar te "asistojne" zgjedhesit, veprim ky totalisht ne kundërshtim me Kodin Zgjedhor, por qe gjithashtu perben krim zgjedhor dhe veper penale.

Ligji eshte shume i qarte: Vetem personat qe nuk kane aftesi fizike per te votuar mund te asistohen. Por personat qe kane mundesi fizike te votojne, nuk kane perse te asistohen. Personat qe nuk jane te shkolluar mjaftueshem apo qe nuk dine te perdorin aparate eletronike nuk bejne pjese tek perjashtimet e Kodit Zgjedhor ndaj te cileve mund te jepej ndihma apo asistenca e dikujt.

Praktika e paligjshme nese eshte toleruar ne ndonje rast apo eshte masive, NUK do te thote se ajo praktike te legjitimohet dhe justifikohet. Fakti se keto praktika nuk jane kontestuar kurdohere nga ana e komisionereve te BF, nuk do te thote aspak se duhen perligjur votimi masiv, votimi familjar, votimi i operatorit ne vend te zgjedhesit apo votimi i asistuar i kryer pa rrespektuar percaktimet e Kodit Zgjedhor.

Prandaj jemi ketu perpara KAS ku kerkojme anullimin e zgjedhjeve ne Bashkine Kamez, pikerisht sepse po i kundershtojme keto shkelje flagrante te Kushtetutes dhe te ligjit.

- Nga ana tjeter, fakti se keto ngjarje kane ndodhur ne menyre sistematike ne Elbasan, duke prekur te 4 KZAZ-te e Bashkisë Elbasan, si dhe konkretisht ne mbi 70-80 % e te gjitha QV, deshmojne per shkelje te renda, te qellimshme dhe sistematike te procesit zgjedhor, shkelje qe kane deformuar rende vullnetin e zgjedhesve dhe lirine e tyre.

- Duke marrë shkas nga keto shkelje, pra nga natyra e shkeljeve të pretenduara në procesin e leximit dhe vlerësimit të votës, e bëjnë të detyrueshme shpalljen e pavlefshme dhe përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar të bashkisë si dhe të Këshillit Bashkiak Elbasan me anë të votimit tradicional me fletë votimi fizike, dhe me garanci të plota për një process të rregullt sipas standarteve.

Duke gene se në vlerësimin tonë ka prova të mjaftueshme për të disponuar sipas objektit të kërkimit, bazuar mbi sa u argumentua më lart, Koalicioni “Bashkë Fitojmë” kërkon:

Ndryshimin e Vendimit nr.177, datë 08.06.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur:

Prishjen e Vendimit të KSHZ Nr.539, datë 20.05.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në Zonën Zgjedhore Bashkia Elbasan, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023”, duke vendosur:

- (i) Pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore Bashkia Elbasan; dhe*
- (ii) Përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë si dhe të Këshillit Bashkiak Elbasan me anë të votimit tradicional me fletë votimi fizike”.*

13. I padituri Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, prapësoi se:

“Ankuesi ka kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore. Pavlefshmëria e zgjedhjeve është mjet ligjor në duart e subjekteve ankuese, i cili mundëson anullimin e votimit/rezultatit dhe përsëritjen e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimit.

Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si shkaqe për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve:

a) shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore;

b) fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose

c) mosfillim i votimit apo pezullim i tij për më shumë se pesë orë.

- KAS-i e ka trajtuar gjerësisht analizën ligjore për kërkimin e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në vendimarrjen e tij për zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 (p.sh. vendimet nr.89, datë 20.05.2021, nr. 91, datë 27.05.2021, nr. 94, datë 31.05.2021, nr. 95, datë 31.05.2021 etj.) Në këto vendime, KAS-i ka arsyetuar, se neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si tipar kryesor për shkeljet e ligjit, me qëllim që ato të trajtohen si shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, peshën e tyre dëmprurëse mbi zgjedhjet. Në këto raste dëmi mund të vijë edhe nga një shkelje e vetme, por tronditëse për zgjedhësit ose rregullshmërinë e procesit (p.sh. cënimi i integritetit të kutive të votimit - nenet 115 dhe 138 të KZ). Përgjatë zgjedhjeve mund të ndodhin parregullsi apo shkelje të shumta, të lehta ose të rënda, të cilat mund të kenë lidhje me aspekte të veçanta të procesit, por jo të gjitha mund të cilësohen “shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor”. Shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga

votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur. Votimi familjar p.sh. që është konstatuar shpesh nga misionet vëzhguese të OSBE/ODIHR-it si shkelje e procesit zgjedhor nuk është konsideruar nga ata kurrë si shkelje që shkakton pavlefshmërinë e zgjedhjeve, sepse ata nuk e kanë vëzhguar asnjëherë këtë shkelje në masën e vet kritike. Po kështu shitblerja e votës, që gjithashtu është kritikuar në një numër zgjedhjesh, nuk është vëzhguar prej tyre në masë kritike.

- KAS-i ka analizuar se Kodi Zgjedhor ka përpunuar mjete ligjore mbrojtëse të ndryshme për shkelje të ndryshme. Për një pjesë prej tyre, mjete ligjor mbrojtës është gjoba administrative (shkeljet e kryera nga media, subjektet zgjedhore, përfaqësuesit e institucioneve), për një pjesë janë masat disiplinore (shkarkimi etj.), për një pjesë është ndjekja penale (shitblerja e votës, shpërdorimi i detyrës, korrupsioni aktiv dhe pasiv në zgjedhje etj.), por për asnjërën prej tyre Kodi nuk ka përcaktuar si mjet ligjor pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Kjo është arsyeja pse ekzistenca e një apo më shumë shkeljeve, qofshin këto edhe të rënda, nuk është shkak i vetëmjaftueshëm për të kërkuar pavlefshmëri. Kjo është arsyeja pse kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik, që vërteton se shkelja e pretenduar është “shkelje që cënon rëndë procesin zgjedhor”, sikurse duhet të shoqërohen edhe me provën se sa dhe si e ka cënuar ajo procesin zgjedhor. Nevoja për provueshmëri imponon edhe nevojën për të provuar lidhjen shkakësore midis shkeljes dhe pasojës së rëndë, pengimit/largimit të zgjedhësve në masë nga votimi, detyrimit të tyre që të votojnë në masë kundër vullnetit, ose tjetërsimit në masë të votës së hedhur.

- KAS-i ka kërkuar që argumentet për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve të jenë konkrete, të faktueshme, të provueshme dhe të matshme. Këto kërkesa që burojnë nga dispozita e pikës 1 të nenit 160 të Kodit Zgjedhor janë konfirmuar edhe nga jurisprudenca kushtetuese dhe zgjedhore shqiptare. Vendimi nr.75, datë 19.04.2002 i Gjykatës Kushtetuese, i cili mund të shërbejë si bazë për të identifikuar metodologjinë për saktësimin dhe konkretizimin e termit “shkelje që cënojnë rëndë procesin zgjedhor”, kërkon që arsyetimi juridik i KAS-it të kalojë nëpërmjet “përcaktimit të kritereve, koncepteve bazë si dhe parimeve mbi të cilat duhet të mbështetet organi kompetent për të konkluduar lidhur me aplikimin e shkakut të përshtatshëm kushtetues”. Shkeljet që cënojnë rëndë procesin zgjedhor duhet të jenë shkelje të tilla që e bëjnë të pavlerë rezultatin e tyre, sikurse “aktet e sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën... (duhet të jenë të tilla që) e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese” për zyrtarin e lartë.

- KAS-i, në shqyrtimin e kërkesave për pavlefshmëri është udhëhequr nga jurisprudenca e Kolegjit Zgjedhor, i cili është marrë posaçërisht me interpretimin e pikës 1 të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, sipas tekstit që është sot në fuqi, në vendimin e tij nr.45, datë 18.11.2013. Kolegji ka konfirmuar karakterin përjashtimor të rasteve të pavlefshmërisë dhe përsëritjes së zgjedhjeve. Sipas Kolegjit Zgjedhor “përsëritja e zgjedhjeve nuk mund të kryhet për çdo shkelje të evidentuar, qoftë kjo edhe lidhur me parimet e zgjedhjeve, përveçse kur provohet se shkeljet janë të tilla që kanë ndikuar në rezultatin final”. Kolegji Zgjedhor çmon se nuk mjafton që të provosh se janë kryer shkelje që kanë cënuar procesin zgjedhor për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve, por duhet të provosh se “këto shkelje të jenë në një masë të tillë sa të mund të kenë ndikuar në ndarjen e mandatit”. Gjithashtu, Kolegji ka saktësuar se pretendimi se shkelja “përbën fenomen masiv, ndaj edhe mund të ketë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve” duhet të provohet në gjykim, përndryshe ngelet në kuadrin e një hipoteze dhe nuk mund të merret për bazë nga gjykata.

- Ankuesi “Bashkë Fitojmë” ka pretenduar në kërkesën ankimore dhe shqyrtimin e ankimit, se në 6 QV ka ndodhur tjetërsim i votës nga regjistrimi i votës në PEVN, tek depozitimi i votes fizike në kuti. Këto raste përfshinin 4 denoncime nga votues të ndryshëm (QV nr. 2373/01, QV nr. 2377, QV nr. 2358 dhe QV nr. 2477), sipas të cilave ata kishin lexuar në votën fizike të printuar

emrin e kandidatit që nuk kishin votuar dhe një pretendim, se rezultati i kutive për dy QV të KZAZ-së nr.47 nuk kuadronte me rezultatin e transmetuar nga pajisja PEVN, gjë që kishte qenë objekt debati midis KZAZ-së dhe administratës së KQZ-së (QV nr. 2481/01 dhe QV nr. 2483). Mbi këtë bazë, ankuesi kërkoi hapjen dhe numërimin e votave fizike për këto 6 QV, me pretendimin se rezultati i numërimit të votave fizike do të dilte i ndryshëm nga ai elektronik dhe do provonte vërtetësinë e denoncimeve.

- KAS-i pranoi për këqyrje dhe numërim të votave fizike në QV nr.2373/01, QV nr.2481/01 dhe QV nr.2483, për shkak se për QV nr. 2373/01 denoncimi ishte bërë publikisht dhe ishte i vërtetueshëm, kurse për dy QV-të e tjera për shkak se pretendimi u konfirmua edhe nga administrata e KQZ-së, por me arsyetimin se debati kishte pasur lidhje jo me transmetimin e shifrave të ndryshme, por me regjistrimin e shifrës zero, të cilën sistemi e merr sa herë që nuk arrin të lexojë USB. Për tre QV-të e tjera, pretendimi ishte i paverifikueshëm. Këqyrja dhe numërimi i votave fizike për 3 QV-të u krye në seancën e datës 05.06.2023. Rezultati provoi përputhjen e plotë të numrit dhe vlerësimit të votave fizike me përmbledhësen e votimit elektronik, duke rrëzuar pretendimin e ankuesit.

- Ankuesi pretendoi se në KZAZ-në nr.47 ishin marrë në dorëzim kutitë e 76 QV-ve në kushte parregullsie (pa vula sigurie). Në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së u gjet vetëm shënimi se “çdo parregullsi apo mungesë është pasqyruar në procesverbalet përkatëse”. Mbi këtë bazë, KAS-i i kërkoi administratës së KQZ-së që t'i vinte në dispozicion ankuesit procesverbalet e dorëzimit të materialeve të votimit dhe numërimit elektronik nga KQV në KZAZ, për gjithë ZAZ-në. Pas marrjes së provës, në seancën e datës 05.06.2023, ankuesi ngriti pretendimin se kutitë e 30 QV-ve ishin marrë në dorëzim me parregullsi të theksuara, të specifikuara për secilën prej tyre. KAS-i i kërkoi administratës së KQZ-së që të mbante qëndrim për këtë konstatim. Në seancën e datës 07.06.2023 administrata raportoi gjendjen faktike ku shprehu se janë 5 kuti pa kod sigurie në kutinë e materialeve zgjedhore; 7 kuti të rregullta; 12 kuti të papërdorura; 4 kuti pa kodin e sigurisë të printerit; 1 PEVN pa kod sigurie të USB-së; 1 QV e përfshirë në listë si me probleme, nuk ekziston në këtë ZAZ.

- Pas këtij konstatimi nga ana e administratës, ankuesi kontestoi raportimin për 2 QV, për QV-në nr. 2379 dhe për QV-në nr. 2446. Mbi këtë bazë, KAS-i vendosi këqyrjen e materialit zgjedhor për këto dy QV. Këqyrja e jashtme e kutive konfirmoi të dhënat e procesverbalit të marrjes në dorëzim, kurse këqyrja e fletëve fizike të votimit konfirmoi rezultatin e pasqyruar në tabelën përmbledhëse. Për QV-në nr.2446 u konstatua diferencë midis numrit të zgjedhësve të prodhuar nga pajisja PEI (132 zgjedhës) me numrin e zgjedhësve të prodhuar nga përmbledhësja e pajisjes PEVN (133 zgjedhës). Administrata e KQZ-së informoi në seancë, se sipas hetimit të kryer prej saj, diferenca me shifrën 1 vinte për shkak të votimit të operatorit, pa u regjistruar nga pajisja PEI.

- “Rregullat procedurale teknike për procesin e votimit elektronik nëpërmjet pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik në Bashkitë Vorë, Kamëz dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, që janë miratuar me vendimin e Komisionerit nr. 415, datë 26.04.2023 përcaktojnë, se si bëhet deklarimi “kuti e parregullt” ose “PEVN e parregullt”. Mungesa e kodit të sigurisë të printerit apo e kodit të sigurisë së USB-së, janë përcaktuar në këtë dokument si shkak për deklarimin “kuti e parregullt”, përkatësisht “PEVN e parregullt”. Tetë kutitë dhe 2 PEVN-të që shfaqën këtë problematikë (QV nr. 2394/01, QV nr. 2457, QV nr. 2476/01, QV nr. 2480, QV nr. 2422/01) janë marrë në dorëzim si të rregullta. Ankuesi nuk lidhi asnjë pretendim dhe asnjë kërkim me këtë fakt. Për këtë arsye, KAS-i nuk mundi të thëllonte më tej hetimin, i cili do kërkonte hapjen e kutive të këtyre QV-ve dhe verifikimin e rezultatit nga votimi elektronik me rezultatin nga numërimi dhe vlerësimi i votave fizike.

- Vendimi i Rregullatorit nr.04, datë 13.11.2020, "Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimin elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë" përcakton në shkronjën "k" të pikës 10 të tij, se "votuesit duhet t'i mundësohet verifikimi dhe konfirmimi i çdo zgjedhjeje të bërë, përfshirë dhe konfirmimin e verifikimit të versionit fizik të votës, si dhe kutia të mundësojë për aq sa është e mundur, fotografimin e votës". Ankuesi ngriti pretendimin se ky kusht teknik është anashkaluar në zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Pajisjet nuk lejonin konfirmimin e votës fizike. Pas konfirmimit të votimit elektronik, vota printohej dhe bëhej e shikueshme në dritaren e printerit për 5 sekonda dhe pastaj binte në kuti, pa i dhënë mundësinë zgjedhësit që të anulonte në këtë fazë votimin. Ky fakt u pranua edhe nga administrata e KQZ-së dhe u justifikua me shpjegimin, se votimi për dy organe të qeverisjes vendore dhe operimi në një votim me dy vota fizike e bëri të pamundur, për pamjaftueshmëri kohore, modifikimin e nevojshëm në programimin e pajisjes.

- Ankuesi pretendoi se operimi në kushte paligjshmërie i pajisjes ka eliminuar një nga garancitë e procesit zgjedhor, që është e drejta e zgjedhësit për të modifikuar në çdo kohë vullnetin, deri në momentin e hedhjes së votës në kutinë e votimit, si dhe ka krijuar pabarazi midis votuesve me votim elektronik dhe atyre me votim manual. Ankuesi nuk argumentoi pse kjo paligjshmëri duhet të formojë shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në gjithë zonën zgjedhore. Në këtë analizë, KAS-i u udhëhoq nga arsyetimi i tij themelor, i trajtuar edhe në rastet e tjera, sipas të cilit shkelja duhet të analizohet në kontekstin e dëmit që i ka sjellë procesit (për më shumë shih vendimet nr.89, datë 20.05.2021, nr.91, datë 27.05.2021, nr.94, datë 31.05.2021, nr.95, datë 31.05.2021 etj.) Midis shkeljes dhe pasojës që sjell ajo duhet të ketë gjithmonë një masë kritike, e cila formon kufirin ndarës midis shkeljes dhe parregullsisë, sporadike, të izoluar, të pjesshme, të përsëritur, të përhapur, të kryer pa dashje ose me qëllim dhe shkeljes që pengon/largon zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyron ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetëron në masë votën e hedhur

- Në rastin konkret, KAS-i e sheh shkeljen kryesisht tek mospërfshirja e Rregullatorit në zgjidhjen që i është dhënë vështirësisë teknike operative. Nëse Rregullatori do të kishte qenë i përfshirë dhe do të kishte modifikuar, për këto zgjedhje, vendimin nr. 04, datë 13.11.2020, atëherë palët e interesuara do të kishin patur mundësinë të ankoreshin ndaj vendimarrjes së Rregullatorit.

E drejta e ankimit ndaj akteve të administratës publike është e drejtë thelbësore. Në këtë rast, palët që kanë patur një interes të ligjshëm nuk janë lejuar t'a mbrojnë interesin e tyre, por janë vënë përpara faktit të kryer. Nevojitet që ankuesi të provojë se zgjedhësve u është hequr një garanci ligjore, e cila ka ndikuar masivisht sjelljen e votuesve dhe i ka penguar masivisht në ushtrimin e lirë të vullnetit të tyre. Ankuesi duhet të provonte, se e drejta për të korrigjuar shprehjen e vullnetit, sa kohë që nuk është mbyllur procedura e votimit, është e drejtë e cila përdoret masivisht në zgjedhje, se ajo është vijë sjelljeje e votuesve shqiptarë dhe se provohet si e tillë nga statistika zgjedhore dhe numri i lartë i votave të dëmtuara, në rastet e votimit manual.

- Pretendimi për cenim të barazisë midis votuesve me votim elektronik dhe me votim manual, për shkak të kësaj difference nuk formon dot shkak për pavlefshmëri zgjedhjesh. Midis votimit manual dhe atij elektronik ka dallime, të cilat vijnë për shkak të mënyrës së ndryshme të votimit. Heqja e mundësisë së anulimit të votës fizike nuk është i vetmi dallim. Për më tepër, heqja e mundësisë së anulimit është bërë për nevojat e realizimit të procesit, jo për nevoja të manipulimit të tij. Nëse nuk do ishte bërë kjo zgjidhje kompromisi, mund të mos ishte realizuar dot votimi elektronik.

- Ankuesi solli në vëmendje të KAS-it vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.169, datë 26.07.2002, në mbështetje të pretendimit se votimi familjar është shkak pavlefshmërie i njohur dhe pranuar nga Gjykata Kushtetuese. KAS-i sjell në kujtesë faktin se Gjykata Kushtetuese atë kohë ka

vepruar si gjykatë e posaçme për shqyrtimin e konflikteve zgjedhore, d.m.th. si Kolegji Zgjedhor Gjyqësor sot. Rasti i gjykuar në atë kohë mund të përdoret si ilustrim për interpretimin që i bën KAS-i pavlefshmërisë së zgjedhjeve. Baza e gjykimit në rastin e vitit 2002 ishte shkelja e ligjit nga KQV-të me vendim dhe pranimi nga KQV-të, si votim i rregullt, i praktikës së votimit familjar në masë. Ky është rasti kur një shkelje e vetme (vendimi i kundraligjshëm i KQV-së) mund të formojë shkak të vetëmjaftueshëm për pavlefshmëri. Rasti i paraqitur nga ankuesi është i ndryshëm nga rasti i gjykuar nga Gjykata Kushtetuese në vitin 2002. Ankuesi paraqiti prova për një gjysëm duzine episodesh të votimit familjar në QV-në e fshatit Labinot Mal. Prova tregonte gjithashtu një komisioner, i cili, të paktën në njerin nga këto raste, ndërhynte për të penguar veprimin e kundërligjshëm. Episodet e denoncuara në QV-të e tjera bëjnë fjalë për votim të asistuar, i cili në vetvete është votim i ligjshëm, por duhet dokumentuar sipas një procedure të caktuar. Në këtë rast, moskryerja e procedurës duhet të cilësohet ligjërisht si parregullsi në administrim.

- Të gjitha shkeljet e identifikuara nga provat video janë shkelje që ndiqen individualisht në kuadër të hetimit penal (neni 327 i Kodit Penal “Shkelja e fshehtësisë së votimit”) ose të hetimit të denoncimeve me karakter administrativ. Si episode shkeljesh, në kuadër të shqyrtimit të kërkesës për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonën zgjedhore, ato nuk plotësojnë kushtin e masës kritike që kërkon neni 160 i Kodit Zgjedhor dhe jurisprudenca zgjedhore.

- Sa i takon pretendimeve për ushtrimin e detyrës së komisionerit apo operatorit në kushtet e papajtueshmërisë, apo të përdorimit të punonjësve të administratës ditën e zgjedhjeve pranë qendrave të votimit për të intimiduar ose shoqëruar zgjedhës të caktuar, ankuesi nuk solli prova për të faktuar pretendimin, apo për të faktuar se ishin zbatuar pa sukses procedurat mbrojtëse që parashikon ligji në këto raste, sikurse nuk solli prova lidhur me masën e ndikimit të secilit prej rasteve të denoncuara në mbarëvajtjen e zgjedhjeve. Pretendimet për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve duhet të jenë konkrete, të faktueshme, të provueshme dhe të matshme. Të tilla këto pretendime nuk ishin në tërësinë e tyre. Pretendimet e tjera të parashtruara në kërkesën ankimore nuk u ndoqën nga ankuesi përgjatë shqyrtimit të ankimit. Ankuesi nuk i ngriti, nuk paraqiti prova në mbështetje të tyre dhe nuk bazoi kërkitime mbi to deri në përfundim të shqyrtimit.

Për sa më sipër, kërkojmë:

-Rrëzimin e kërkesë padisë të paraqitur nga paditësi, Koalicioni “Bashkë Fitojmë” si të pambështetur në ligj dhe në prova.

-Lënien në fuqi të vendimit nr. 177, datë 8.6.2023, të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve.

14. Pala e interesuar, subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë, ka prapësuar se:

“-18. Vendimi Nr.177, datë 08.06.2023 i Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve është vendim i drejtë, i bazuar në ligj e në prova dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Të gjitha pretendimet e ngritura nga paditësi, si në ankimin përpara KQZ ashtu edhe në Kolegji Zgjedhor vlerësohen të pabazuar në ligj dhe në prova dhe padi duhet rrëzuar pasi asnjë prej shkeljeve të pretenduara nuk provohet dhe më tej nuk argumentohet nëse këto shkelje e kanë çenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë që të justifikojë pavlefshmërinë e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore Bashkia Elbasan.

- 19.Në lidhje me pretendimin se ka shkelje të vendimit të Komisionit të Rregullatorit nr. 04, datë 13.11.2020, “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë” përcakton në shkronjën “k” të pikës 10 të tij , se “votuesit duhet t’i mundësohet verifikimi dhe konfirmimi i çdo zgjedhjeje të bërë përfshirë dhe konfirmimin e verifikimit të

versionit fizik të votës, si dhe kutia të mundësojë për aq sa është e mundur, fotografimin e votës”. Pra, votuesi nuk e kishte mundësinë e konfirmimit e verifikimit të versionit fizik të votes.

19.1.Në lidhje me procesin e votimit elektronik, u bë edhe një eksperiment pranë KAS dhe kishim mundësinë që të shikonim procedurën e votimit, që në vlerësimin tonë plotësonte të gjithë garancitë kushtetuese dhe të atyre të parashikuara në Kodin Zgjedhor, i ndryshuar.

19.2.Mënyra se si është hartuar dhe shkruar në rregullor dispozita e pretenduar si e shkelur, në vlerësimin tonë është disi e paqartë. Votuesi, pasi bën të gjitha veprimet në ekranin me prekje PEVN dhe klikon opsionin “Konfirmo”, pregatitet dhe shikon, nëpërmjet një dritare të vogël tek kutia e votimit, fletën teksa printohet, të ndricuar. Këtu i jepet mundësia që të verifikojë përzgjedhjen që ai ka bërë. Fleta pasi qëndron pak sekonda, mjaftueshëm për verifikim, pritët nga aparatura dhe bie brenda në kuti. Pas kësaj flete, po të njëjtën rrugë ndjek edhe fleta tjetër për Këshillin Bashkiak (apo kryetarin e Bashkisë, sipas rastit). Pra, votuesi verifikon në letër konfirmimi e tij të bërë në mënyrë elektronike në ekranin PEVN. Pra, votuesi përzgjedh dhe konfirmon në ekran dhe verifikon konfirmimin e tij në fletën fizike, nëpërmjet dritares së vogël printerit tek kutia e votimit. Kështu formulimi më i rregullt i dispozitës duhej të ishte “ verifikim i konfirmimit në versionin fizik të votës”. Vetë kjo dispozitë është hartuar në mënyrë të paqartë pasi, në fund të fjalisë parashikohet që “...kutia të mundësojë për aq sa është e mundur, fotografimin e votes” veprim ky i ndaluar po nga ky vendim në germën “d” të pikës 10.

19.3. Padiësi pretendon se “heqja e kësaj garancie shtesë” e ka diskriminuar zgjedhësin në Elbasan në krahasim me zgjedhësit e tjerë që kanë votuar në rrugë elektronike. KAS i ka dhënë përgjigje shteruese këtij pretendimi (shiko pikat 16-19 të vendimit). Në vlerësimin tonë garancitë kushtetuese dhe ligjore janë plotësuar dhe plotësohen të gjitha nga kjo mënyrë votimi dhe nuk mund të konsiderojmë parashikimin në germën “k” të pikës 10 të vendimit Nr.4/2020 të K.RR si një “garanci” për të drejtat e zgjedhësve pasi këto janë vendosur në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor në fuqi. Edhe në votimin klasik, me fletë fizike, pasi kjo e fundit futet në kuti nuk ekziston mundësia që zgjedhësi të kërkojë po atë fletë apo tjetër për të votuar sërish. Menyra se si e parashtron kërkimin padiësi, duket sikur ai kërkon që të kthejë mbrapsht gjithcka, pasi zgjedhësi ka bërë përzgjedhjen e tij duke përfunduar me printime fletës. Pra, ai kërkon që votuesit t’i jepet mundësia që të “grisë” fletën e votimit dhe të fillojë votimin nga e para për një subjekt tjetër.

Kjo nuk ka ndodhur dhe nuk ndodh!

Sa më sipër, pretendimi se ka shkelje të vendimit të Komisionit të Rregullatorit nr. 04, datë 13.11.2020 është i pabazuar në prova dhe si i tillë nuk duhet të pranohet nag Kolegji.

20.Sa i takon pretendimit se për votimin e kandidatit Luçiano Boçi ka pasur vonesa të pashpjegueshme si dhe disa votues janë larguar pa përfunduar procesin e votimit, proces ky i përfunduar nga operatorët sipas orientimeve politike, është një pretendim absurd dhe i paprovuar. Kujtojmë këtu, se në çdo qendër votimi, Kodi Zgjedhor për të garantuar një proces të drejtë, i jep mundësinë subjekteve garuese të monitorojnë procesin jo vetëm nëpërmjet komisionerëve por dhe nëpërmjet vëzhguesve. Në asnjë rast, nga asnjë komisioner apo vëzhgues ditën e votimit nuk është ngritur ky pretendim. Sqarojmë se sesioni i votimit zgjat 5 minuta. Në rast se kjo kohë tejkalohet nga votuesi, pajisja automatikisht anulon votimin për këtë votues. Theksojmë se nenit 160/1/c i K.Z, njeh si rrethanë mbi të cilën vendoset pavlefshmëria e zgjedhjeve në qendrën e votimit vetëm atëherë kur “votimi nuk ka filluar apo është pezulluar për më shumë se pesë orë.”. Kështu, ky pretendim është i pabazuar në ligj e në prova.

21.Lidhur me pretendimin se operatorët e caktuar në qendrat e votimit janë përzgjedhur në kundërshtim me kriteret, pasi në masë ishin familjarë të punonjësve të administratës dhe kryetarë të organizatës të PS, ose dhe vetë punonjës të administratës vendore ose qendrore, sqarojmë se ky pretendim mbetet sërish në kuadrin e dyshimeve dhe hipotezave. Operatorët janë

përzgjedhur nga KQZ në përmbushje të kushteve dhe kriterëve të miratuara në akte nënligjore dhe Partia Socialiste, apo kandidati për Kryetar Bashkie nuk kanë pasur dhe as mund të kenë ndonjë rol në këtë përzgjedhje. Për më tepër, operatorët nuk janë kontestuar për asnjë moment as para dhe as gjatë procesit zgjedhor nga Komisionerët apo vëzhguesit e Kualicionit BF.

22. Sa i takon pretendimit të shoqërimit të votuesve nga ana e Komisionerëve, operatorëve, punonjësve të administratës vendore e qendrore dhe mosplotësimi i deklaratave, sërish ky pretendim është i pambështetur në fakte dhe prova. Sërish sqarojmë se në asnjë rast ky pretendim nuk është ngritur nga Komisionerët apo vëzhguesit e Kualicionit BF, në asnjë qendër votimi. Sa i takon operatorit, sqarojmë se referuar Manualit të miratuar nga KQZ për funksionin e operatorit, atij i njihet e drejta që ta udhëzojë votuesin për përdorimin e paisjes pa e orientuar apo ndikuar në mënyrën e votimit. Në asnjë rast nuk ka patur deformim të vullnetit të zgjedhësit dhe absolutisht nuk mund të pretendohet se keto veprime kanë ndikuar në rezultat.

23. Padiësi pretendon për ndikim në tjetërsim të votës nëpërmjet shpërndarjes së disa lejesh legalizimi, raste punësimi. KAS i ka trajtuar këto pretendime dhe nuk ka gjetur asnjë provë mbi këto pretendimet.

24. Pala ankuese bën fjalë për punonjës të administratës shtetërore apo biznese që kanë intimiduar zgjedhësit. Faktet e referuara nuk provohen, nuk krijojnë lidhje faktike dhe logjike me shkelje të Kodit Zgjedhor dhe nuk provojnë kërkesën për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve.

25. Pretendohet se në disa QV ka pasur të përfshirë komisionerë në konflikt interesi, pasi janë punonjës Bashkie, dhe janë përmendur emrat e tyre (fq. 6 e akt padisë).

Për QV 2328, rezulton se Dhurata Mata është punonjëse në Hekurudhë.

Për QV 2355, rezulton se Eduart Çala është pensionist.

Për QV 2351, rezulton se Anita Qirko është punonjëse në Ujësjellës dhe nuk ka mardhënie pune me kandidatin, ndërsa Uliks Qirko nuk ka gene anëtar komisioni.

25.1. Të gjitha këto provohen me vendimet e KZAZ- ve përkatëse të cilat janë përcjellë pranë KQZ. Sa i takon vëzhguesve sqarojmë se nuk ka pengesë ligjore nëse ata janë në marrëdhënie pune me kandidatin, por për transparencë ju informojmë se vëzhgues në QV 2328 ka gene Etleva Rozani.

26. Pretendimet e tjera që ka patur blerje të votës, ka patur presione dhe intimidime, se janë përdorur biznese VIP për t'iu kërkuar me detyrim votën punonjësve të tyre; asfalti elektoral dhe se punonjës të administratës kanë qënë në cdo qendër votimi, nuk janë shoqëruar me asnjë provë në shqyrtimin administrativ në KAS dhe për sa kohë gjendja e provueshmërisë vazhdon të jetë e njëjtë edhe përpara Kolegjit, duhet të rrëzohen si të pabazuar në ligj e në prova. Pala as nuk arsyeton se si mund të kenë ndikuar në rezultatin zgjedhor.

27. Në lidhje me provat filmike që janë depozituar nga padiësi, pasi iu vunë në dispozicion pamjet nga K.Q.Z, K.A.S ka bërë një vlerësim të drejtë të atyre provave dhe nuk ka vend për çenim të vendimit.

III. Pretendimi për pavlefshmërinë e zgjedhjeve nuk duhet të pranohet.

28. Neni 160 i K.Z i ndryshuar, parashikon se:

1. KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, i shpall zgjedhjet të mpavlefshme në një apo më shumë qendra votimi, në rast se:

a) kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit, sipas kësaj shkronje, të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore;

b) kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose

c) votimi nuk ka filluar apo është pezulluar për më shumë se pesë orë.

2. Subjektet zgjedhore, në përputhje me rregullat dhe afatin e përcaktuar në nenin 124 të këtij Kodi, kanë të drejtë të kërkojnë në KQZ shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi.

3. Kërkesa për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve duhet të përmbajë shkaqet ligjore përshkrimin e rasteve të shkeljeve dhe arsyetimin e detajuar për pasojën e tyre.

4. Shqyrtimi i kërkesave bëhet sipas procedurave të përcaktuara në pjesën X të këtij Kodi. KQZ-ja, në marrjen e vendimit për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, mund konsultohet me KZAZ-në përkatëse. Në arsyetimin e vendimit të KQZ-së duhet të përshkruhet shkaku ligjor, rastet e vërtetuara të shkeljeve dhe arsyetimi i detajuar për pasojën e tyre.

29. Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si tipar kryesor për shkeljet e ligjit, me qëllim që ato të trajtohen si shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, peshën e tyre dëmprurëse mbi zgjedhjet. Në këto raste dëmi mund të vijë edhe nga një shkelje e vetme, por tronditëse për zgjedhësit ose rregullshmërinë e procesit (p.sh. cënimi i integritetit të kutive të votimit - nenet 115 dhe 138 të KZ). Përgjatë zgjedhjeve mund të ndodhin parregullsi apo shkelje të shumta, të lehta ose të rënda, të cilat mund të kenë lidhje me aspekte të veçanta të procesit, por jo të gjitha mund të cilësohen "shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor". Shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur .

30. Padiësi ka identifikuar rreth 12 qendra votimi në të gjithë ZAZ Bashkia Elbasan por nuk argumenton se pse shkelja e ligjit në këto QV, është aq e rëndë sa sjellë si pasojë pavlefshmërinë jo vetëm në këto qendra por në të gjitha QV të të 4 ZAZ të Bashkisë Elbasan.

31. Kodi Zgjedhor lejon si shkak për pavlefshmërinë edhe një tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore. Në dallim nga shkakun themelor, ky rast kërkon më shumë se sa një shkelje, me një shkallë më të ulët cënimi. Në këtë rast nuk duhet që të ketë pasur pengim/largim të zgjedhësve në masë nga votimi, detyrim të tyre që të votojnë në masë kundër vullnetit, apo tjetërsim në masë të votës së hedhur, por mjafton që ky fenomen (pengimi/largimi i zgjedhësve nga votimi, detyrimi për të votuar kundër vullnetit, apo tjetërsimi i votës) të ketë ndodhur në atë shkallë, sa të mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve. Edhe në këtë rast, kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik pse shkelja e pretenduar është "shkelje që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve", si dhe me proven për përmasën e ndikimit dhe lidhjen shkakësore.

32. ...Kolegji vlereson se duke qënë një perjashtimor, ne thelb kerkohet te nenvizohet parimi i rëndesishëm i "paprëshmërisë së procesit zgjedhor", parim nga i cili nuk mund te ketë perjashtim edhe Kolegji Gjyqësor. Procesi i vendimmarrjes lidhur me pazgjedhshmerine ose me kundërshtimin e rezultateve zgjedhore duhet te jete brenda kornizes se nje minimum garancish kundër arbitraritetit. Vendimet per shpallje te nje votimi si te pavlefshëm duhet t'i pergjigjen pamundësie reale per te percaktuar deshirat e zgjedhësve (Vendimi i GJEDNJ-st Ukraines nr.39424/02, GiEDNi 2008). Ne çështjen Kerimova k. Azerbajhanit, nr.20799/06, 30 shtator 201 GJEDNJ-se arriti ne perfundimin/konkluzionin se, falsifikimet e kryera nga dy zyrtar nuk kishin arritur ta shtremberonin rezultatit perfundimtar te zgjedhjeve, te fituara nga padiësjja. Pavarësisht sipas Giykatës, autoritetet kombëtare i kishin shpallur të pavlefshme në shkelje të drejtës së brendshme zgjedhore dhe pa marre parasysh përmasat e vogla te falsifikimeve te lartpërmendura...

33. Vlen të theksojmë se Kodi Zgjedhor ka përpunuar mjete ligjore të ndryshme për shkelje të ndryshme, siç janë gjoha administrative, masat disiplinore, ndjekja penale, por për asnjërën

prej tyre Kodi nuk ka përcaktuar si mjet ligjor pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Kjo është arsyeja pse ekzistenca e një apo më shumë shkeljeve, qofshin këto edhe të rënda, nuk është shkak i vetëmjaftueshëm për të kërkuar pavlefshmëri. Kjo është arsyeja pse kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik që vërteton se shkelja e pretenduar është “shkelje që cënon rëndë procesin zgjedhor”, sikurse duhet të shoqërohen edhe me provën se sa dhe si e ka cënuar ajo procesin zgjedhor. Nga pala ankuese në asnjë rast nuk provohet lidhja midis shkeljeve të pretenduara dhe pasojës së ardhur (pavlefshmëri e procesit zgjedhor).

34. Duhet të sjellim në vëmendje se vetë Kodi Zgjedhor parashikon një sërë garancish të cilat mbrojnë procesin zgjedhore dhe që janë komplementare, me qëllim që dhe kur ndonjëri prej tyre nuk funksionon, dështon apo administrohet keq, mos dëmtohet procesi. Psh, nëse nuk funksionon paisja PEI, atëherë mund të bëhet identifikimi nëpërmjet listës së zgjedhësve, etj.

35. Në rastin konkret, sipas tabelave të miratuara nga K.SH.Z rezulton se diferenca në vota ndërmjet kandidatëve për kryetar bashkie është + 8,073 vota në favorin e kandidatit Llatja, i P.S.SH. Ndërsa për Këshillin Bashkiak diferenca është 17,654 vota në favorin e P.S.SH. Asnjë prej shkeljeve të pretenduara nuk u argumentua nëse kanë ndikuar në rezultat dhe në cfarë mase. Për këtë shkak kërkesa për marrje provash duhet të rrëzohet nga KAS.

36. Në lidhje me referimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.169, datë 26.07.2002. Gjykata Kushtetuese në atë kohë ka patur një bazë faktike të provuar e të dokumentuar, situatë kjo që është tërësisht e ndryshme nga gjendja e faktit dhe provueshmëria e pretendimeve në këtë gjykim. Sipas vendimit në fjalë rezulton se:

- “ ...6 nga 7 anëtarët e Komisionit kanë pranuar të “votohet edhe për anëtarë të familjes, përjashtuar emigrantët”

- “...Kjo Gjykatë konstatoi se në një shumicë rastesh dhe në mënyrë të dukshme kishte nënshkrime të njëjta për votues të një familje, gjë që bën bindës pretendimin e kërkuarit se ka votuar një person edhe për anëtarët e tjerë të familjes.”

- “...komisionet e lartpërmendura të qendrave të votimit, në kundërshtim me ligjin, kanë lejuar me marrëveshje të komisionerëve, që zgjedhësit të votojnë në emër të familjarëve të tyre.”

36.1. Sigurisht që votimi familjar nuk lejohet as sot, por paditësi ka dështuar në cdo formë që të provojë pretendimet e tij në atë masë sa i gjithë votimi, në një apo disa qendra të konsiderohet i pavlefshëm sipas nenit 160 të K.Z, i ndryshuar.

37. Sa më sipër vlerësojmë se shkeljet e pretenduara nuk krijojnë aspak dyshime që ato të kenë ndikuar në procesin zgjedhor dhe të sjellin pasojat e paashikuara nga neni 160 i Kodit Zgjedhor. Argumentet për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve duhet të jenë konkrete, të faktueshme, të provueshme dhe të matshme. Asnjë prej shkeljeve nuk provohet të ketë shkaktuar pamundësi reale për të përcaktuar dëshirën dhe vullnetin e zgjedhësve në Bashkinë Elbasan në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023.

Përfundimisht, për sa parashtruam më sipër, në bazë të nenit 158, 3 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor kërkojmë rrëzimin e plotë të padisë”.

ARSYETIMI I KOLEGJIT

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, çmon të nevojshme të evidentojë paraprakisht faktin se, kërkespatria objekt shqyrtimi rezultoi të ishte kopje e pandryshuar e ankimit të palës paditëse në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, pasi në përmbajtjen e saj mungojnë argumentat mbi paligjshmërinë e vendimmarrjes se këtij të fundit, njëjtë sikur shqyrtimi administrativ i ankesës të mos ishte ezauruar para ngritjes së padisë.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konstatoi ngritjen në përmbajtje të kërkespadise, të pretendimit se:

- Duke marrë shkas nga të dhënat e vëzhguesve dhe të numëruesve në GNV, Koalicioni Bashkë Fitojmë, kërkon marrjen e provës nga KOZ të pajisjes me regjistrimet e kamerave të procesit të numërimit në Bashkinë Elbasan. Nga verifikimi i këtyre pamjeve filmike do të rezultojë anomali apo parregullsive në kualifikimin jo të rregullt të votës, kjo sipas evidencave dhe sipas konstatimit të pamjeve filmike pasqyruar në QV-të e ZAZ;

- Nderkohe që ne Kamez, ne kemi arritur të provojmë pa asnjë medyshe se ka ndodhur votim masiv apo votim familjar në dhjetra e qindra raste në 14-Maj 2023 dhe askush nuk është perballur deri më tani me pergjegjesi ligjore apo penale nga ana e institucioneve ligjzbatuese.

- Gjithashtu, garancia që kërkohet është përpara votimit, duhet detyrimisht që personi të ketë nënshkruar deklaratën në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-e perkatëse si dhe të angazhohet se nuk do të bëjë publike votën. Merrini ju si KAS protokollin e mbledhjeve e të gjitha QV ne Kamez mbi bazën e Nenit 21 të Kodit Zgjedhor dhe do të shihni se aty nuk ka thuar asnjë rast ku të jete shenuar Deklarata në fjale në asnjë QV të Bashkisë Elbasan;

- Praktika e paligjshme nëse është toleruar në ndonjë rast apo është masive, NUK do të thote se ajo praktike të legjitimohet dhe justifikohet. Fakti se këto praktika nuk janë kontestuar kurdoherë nga ana e komisionereve të BF, nuk do të thote aspak se duhen perligjur votimi masiv, votimi familjar, votimi i operatorit në vend të zgjedhësit apo votimi i asistuar i kryer pa rrespektuar percaktimet e Kodit Zgjedhor.

Prandaj jemi këtu përpara KAS ku kërkojmë anulimin e zgjedhjeve në Bashkinë Kamez, pikerisht sepse po i kundërshtojmë këto shkelje flagrante të Kushtetutës dhe të ligjit.

Thënë kjo, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konstaton se, kërkimet objekt padie diktojnë verifikimin e ekzistencës ose jo të rrethanave, për shkak të të cilave, zgjedhjet vendore për kryetar të Bashkisë Elbasan do të cilësoheshin të pavlefshme, me pasojë përsëritjen e tyre.

Kodit Zgjedhor i parashikon këto rrethana dhe pasoja, në Nenin 160 dhe 161, që parashikojnë respektivisht se:

Neni 160

“1. KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra votimi, në rast se:

a) kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit, sipas kësaj shkronje, të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore;

b) kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose

c) votimi nuk ka filluar apo është pezulluar për më shumë se pesë orë.

2. Subjektet zgjedhore, në përputhje me rregullat dhe afatin e percaktuar në nenin 124 të këtij Kodi, kanë të drejtë të kërkojnë në KQZ shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi.

3. Kërkesa për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve duhet të përmbajë shkaqet ligjore përshkrimin e rasteve të shkeljeve dhe arsyetimin e detajuar për pasojën e tyre.

4. Shqyrtimi i kërkesave bëhet sipas procedurave të përcaktuara në pjesën X të këtij Kodi. KQZ-ja, në marrjen e vendimit për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, mund konsultohet me KZAZ-në përkatëse. Në arsyetimin e vendimit të KQZ-së duhet të përshkruhet shkaku ligjor, rastet e vërtetuara të shkeljeve dhe arsyetimi i detajuar për pasojën e tyre”.

Neni 161

“1. Pas përfundimit të procesit të ankimit, jo më vonë se 3 ditë nga nxjerrja e rezultatit të zonës zgjedhore, KQZ-ja kryesisht ose me kërkesë të subjektit, **shpall të pavlefshme dhe urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore, kur pavlefshmëria e shpallur në një ose disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi, ndikon në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore ose në shkallë vendi.**

2. ... Për zgjedhjet për kryetar të qeverisjes vendore ndikim në rezultat do të konsiderohet kur numri i zgjedhësve në qendrat e shpallura të pavlefshme është më i madh se diferenca midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave të vlefshme.

3. Në rast pavlefshmërie për shkak të fatkeqësisë natyrore, sipas shkronjës “b”, apo të mosfillimit të votimit ose pezullimit më shumë se pesë orë të tij, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 160, merret në konsideratë numri total i zgjedhësve të regjistruar në qendrën e votimit të shpallur të pavlefshme.

4. Në rast pavlefshmërie për shkelje të ligjit, **sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 160, apo kur votimi është shpallur i pavlefshëm, sipas paragrafit të dytë të pikës 4 të nenit 138 të këtij Kodi dhe kur procesi i votimit ka përfunduar, sipas këtij Kodi, për përcaktimin e ndikimit merret në konsideratë numri i zgjedhësve që kanë votuar në qendrën e votimit të shpallur të pavlefshme.** ...”.

Nga përmbajtja e dispozitave të mësipërme rezulton i qartë vullneti i ligjvënësit për të garantuar një proces zgjedhor të drejtë, të ndershëm dhe që të përfaqësojë vullnetin e zgjedhësve në ndarjen e mandateve. Përballë këtij standardi dhe fakteve eventuale, që shoqërojnë votimin dhe që cilësohen si shkelje të ligjit zgjedhor, ligjvënësi ka pranuar të vendosë një balancë sipas së cilës, shkeljet që mund të kenë ndodhur gjatë votimit, jo domosdoshmërisht pasjellin pavlefshmërinë e tij. Kështu për shembull, në një votim mund të evidentohen një sërë votash të pavlefshme, por kjo nuk do të thotë automatikisht se i gjithë votimi do të konsiderohet i tillë (i pavlefshëm).

Proporcionaliteti i pranuar nga ligjvënësi, synon të vendosë ekuilibrin mes garancive individuale të çdo kandidati dhe çdo zgjedhësi për votim të lirë, të fshehtë e të ndershëm dhe garantimit të vetë procesit zgjedhor në tërësi. Për rrjedhojë, që të arrihet në përfundimin se zgjedhjet do të duhet të përsëriten për shkak të pavlefshmërisë, do të duhet që të vërtetohet se i gjithë procesi u shoqërua me shkelje të caktuara dhe prodhoi një rezultat që nuk përputhet me vullnetin e zgjedhësve në tërësi, sepse shkeljet e diktuan vetë rezultatit. Nëse kjo nuk vërtetohet, zgjedhjet nuk shpallen të pavlefshme, pavarësisht se shkelje të caktuara vërtetohen të kenë ndodhur.

Formulimi i Nenit 161 të Kodit Zgjedhor është shprehje e parimit të proporcionalitetit, që rast pas rasti, në varësi të shkakut të pavlefshmërisë (sipas të njëjtës dispozitë), përcakton se në cilat rrethana do të duhej të përsëriteshin zgjedhjet, në një ose disa qendra votimi.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, rasti në shqyrtim lidhet me shkronjën “a” të paragrafit të parë të Nenit 160, sipas të cilit , zgjedhjet shpallen të pavlefshme në një ose disa qendra votimi kur kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit, sipas kësaj shkronje, të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore. Në këtë rast, pavlefshmëria e zgjedhjeve në një ose disa qendra votimi, do të shoqërohet me shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve, vetëm nëse numri i zgjedhësve në qendrat e shpallura të pavlefshme është më i madh se diferenca midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave të vlefshme (paragrafi i dytë i Nenit 161 të Kodit Zgjedhor).

Nisur nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se, që të vendoset përsëritja e zgjedhjeve vendore, duhet të vërtetohet:

- (i) pavlefshmëria e zgjedhjeve në një ose disa qendra votimi të caktuara;
- (ii) numri i zgjedhësve që kanë votuar në qendrën/qendrat e shpallura të pavlefshme, të jetë më i madh se diferenca midis dy kandidatëve, që kanë marrë numrin më të madh të votave të vlefshme.

Për rrjedhojë, procesi i verifikimit të ligjshmërisë së zgjedhjeve, në kuadër të pretendimeve qoftë për ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve, qoftë për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, do të duhet të synojë vërtetimin e fakteve që lidhen me shkeljet konkrete të ligjit gjatë procesit zgjedhor dhe me ndikimin/efektin që sjellin ato shkelje në qendrën përkatëse të votimit ku ato janë kryer, si dhe në procesin e votimit në tërësi, duke argumentuar pasojën që ka/kanë shkelja/shkeljet e vërtetuara. Kjo do të thotë se, konsumimi i shkeljeve të ligjit zgjedhor nuk përbën një fakt të mjaftueshëm, që të zhbëjë votimin në qendra të caktuara apo në të gjithë zonën zgjedhore, pasi duhet të vërtetohet se shkelja/shkeljet e kryera kanë ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin e votimit. Vetëm në këtë rast, ligjvënësi nuk legjitimon procesin, për arsye se rezultati nuk përputhet me vullnetin e zgjedhësve, çka bie ndesh me vetë thelbin e demokracisë.

Kjo është arsyeja për të cilën, Kodi Zgjedhor ngarkon ankuesin që, në rast të pretendimit për pavlefshmëri zhdhesh, të paraqesë shkaqet ligjore, përshkrimin e rasteve të shkeljeve dhe arsyetimin e detajuar për pasojën e tyre. Nëse ankuesi dështon të paraqesë argumente bindëse, lidhur me këtë aspekt të procesit (si për shkeljet konkrete, ashtu edhe për pasojën e tyre), zgjedhjet nuk mund të përsëriten.

Në këtë kontekst, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, konfirmon qëndrimin e KAS se:

“6...Përgjatë zgjedhjeve mund të ndodhin parregullsi apo shkelje të shumta, të lehta ose të rënda, të cilat mund të kenë lidhje me aspekte të veçanta të procesit, por jo të gjitha mund të cilësohen “shkelje që cënojnë rëndë procesin zgjedhor”. Shkelje që cënojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur...

8.KAS-i ka analizuar se Kodi Zgjedhor ka përpunuar mjete ligjore mbrojtëse të ndryshme për shkelje të ndryshme. Për një pjesë prej tyre, mjete ligjor mbrojtës është gjoba administrative (shkeljet e kryera nga media, subjektet zgjedhore, përfaqësuesit e institucioneve), për një pjesë janë masat disiplinore (shkarkimi etj.), për një pjesë është ndjekja penale (shitblerja e votës,

shpërdorimi i detyrës, korrupsioni aktiv dhe pasiv në zgjedhje etj.), por për asnjërën prej tyre Kodi nuk ka përcaktuar si mjet ligjor pavlefshmërinë e zgjedhjeve...”.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, referuar pretendimeve të ngritura në padi nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, konstaton se, natyra e shkeljeve të referuara përmes tyre, mund të kategorizohet në dy grupe:

- I. Pretendime që lidhen me votimin elektronik;
- II. Pretendime që lidhen me shkelje të tjera.

I. Lidhur me votimin elektronik.

Pala paditëse, si shkak themelor pavlefshmërie, që ka tjetërsuar në mënyrë masive votën e qytetarëve të Elbasanit, identifikon programimin paraprak të rezultatit të zgjedhjeve vendore, me anë të Pajisjes Elektronike të Votimit dhe Numërimit (PEVN).

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, votimi elektronik, si mënyrë e posaçme e votimit, e ndryshme nga ajo tradicionale me fletë votimi fizike, rregullohet në Nenet 22 dhe 23 të Kodit Zgjedhor, që parashikojnë respektivisht se:

Neni 22

“1. KQZ-ja ka kompetencë të eksplorojë, eksperimentojë dhe të vendosë përdorimin në zgjedhje të sistemeve dhe/ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit, për të mbuluar aspekte dhe/ose procedura të veçanta të procesit zgjedhor, të angazhojë konsulencë të huaj për këtë qëllim, si dhe të prokurojë sisteme apo pajisje të teknologjisë së informacionit apo edhe shërbimin e operimit të tyre. KQZ-ja është e detyruar që përdorimin e sistemeve dhe/ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit ta zbatojë në zgjedhje nëpërmjet projekteve pilot, në jo më pak se 10 për qind të numrit të zgjedhësve për çdo fazë të implementimit.

2. ...

3. Përdorimi i sistemeve ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit bëhet në përputhje me rregullat e posaçme lidhur me procedurat për aspektet e veçanta të procesit, që mbulohen nga sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit. Rregullat procedurale për këtë qëllim miratohen me akt normativ të KQZ-së.

4. Sistemet ose pajisjet e teknologjisë së informacionit që KQZ-ja vendos të përdoren në zgjedhje duhet të synojnë, në radhë të parë, identifikimin elektronik të votuesve dhe verifikimin paszgjedhor të tyre, votimin me dhe nëpërmjet pajisjeve elektronike dhe numërimit nga pajisjet të votave të hedhura, si dhe të jenë të aplikueshme së paku për pesë procese zgjedhore të njëpasnjëshme.

5. Identifikimi, përzgjedhja dhe përdorimi i sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit u nënshtrohen parimeve të ligjshmërisë, transparencës, gjithëpërfshirjes, sigurisë, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë.

6. Përpara çdo procesi zgjedhor, sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit duhet t'i nënshtrohen testimi operacional nga KQZ-ja në seanca publike dhe me procedurë të saktë dhe të detajuar, duke përzgjedhur me kriter rastësor për secilën zonë zgjedhore jo më pak se tre për qind të pajisjeve që do të përdoren dhe duke simuluar me to veprimet operationale zgjedhore për një numër jo më të vogël se 50 votues.

7. Pas çdo procesi zgjedhor, pas nxjerrjes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve dhe konstituimit të organeve të zgjedhura, KQZ-ja kryen në seanca publike dhe me procedurë të detajuar verifikimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë informatike, që janë përdorur për votimin dhe numërimin e votave në zgjedhje, nëpërmjet numërimit manual të jo më pak se 10 për qind të qendrave të votimit dhe krahasimit të rezultatit me rezultatin e nxjerrë nga sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit. Qendrat e votimit përzgjidhen nga KQZ-ja me kriter rastësor për secilën zonë zgjedhore.

8. Rezultatet e testimit parazgjedhor dhe të verifikimit paszgjedhor të sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit kushtëzojnë vendimmarrjen e KQZ-së për përdorimin në vijim të teknologjisë. Rezultatet e testimit parazgjedhor dhe të verifikimit paszgjedhor mund të bëhen objekt i hetimit për kryerje të veprës penale nëse nxjerrin të dhëna dhe krijojnë dyshime për kryerjen e veprave penale nëpërmjet keqpërdorimit të sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit në zgjedhje”.

Neni 23

“1. Sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit në zgjedhje vihen në përdorim nga personeli i kualifikuar i KQZ-së, i punësuar për këtë qëllim, përveçse kur Rregullatori vendos që përdorimi i tyre të bëhet nga operatorë privatë të kontraktuar sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin e shërbimeve. Prokurimi i shërbimit mund të jetë pjesë e kontratës për prokurimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe mund të kryhet edhe nga furnizuesi i këtyre të fundit.

2. Përdorimi i sistemeve ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit kryhet në përputhje me rregulloren teknike të përdorimit, e cila, përveç rregullave që burojnë nga manuali i përdorimit, duhet të përfshijë rregullat për testimin parazgjedhor, për dokumentimin e procedurave operacionale, për konstatimin dhe raportimin e defekteve, shkeljeve apo dhunimeve gjatë operimit, për pezullimin e operacioneve me dhe nëpërmjet sistemeve apo pajisjeve dhe kryerjen e procedurave manualisht, si dhe për përmbylljen e veprimeve operacionale me dhe nëpërmjet sistemeve dhe pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe raportimin e rezultateve. Rregullorja teknike e përdorimit të sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë informatike miratohet me akt normativ të KQZ-së.

3. Në rastet kur nga testimi parazgjedhor rezulton se sistemet apo pajisjet shfaqin defekte apo pasaktësi operacionale, të cilat mund të cenojnë integritetin e tyre apo të procedurave, atëherë KQZ-ja mund të vendosë zbatimin e procedurave manualisht dhe të heqë sistemet apo pajisjet nga përdorimi në zgjedhjet e radhës”.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, votimi dhe numërimi elektronik lidhet me vullnetin e ligjvënësit për të eksperimentuar në fushën e përdorimit të teknologjisë së informacionit. Për këtë, ligji i ka dhënë kompetencën KQZ-së, që të përdorë pajisje të teknologjisë së informacionit, përfshirë ato për votimin dhe numërimin elektronik, duke vënë edhe një kufi minimal të përdorimit në çdo proces zgjedhor me projekte pilot, në jo më pak se 10 për qind të numrit të zgjedhësve për çdo fazë të implementimit.

Për herë të parë në Shqipëri, pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik u eksperimentuan në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2021. Në vijim, edhe për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023, KQZ-ja eksperimentoi përdorimin e pajisjeve teknologjike të votimit dhe numërimit elektronik në tri bashki të vendit (Elbasan, Kamëz dhe Vorë).

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet Vendimit Nr.415 Dt.26.04.2023, ka miratuar rregullat procedurale teknike për administrimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor të votimit dhe numërimit elektronik në Bashkitë Vorë, Kamëz dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Mbi këtë akt individual, u realizua procesi zgjedhor për kryetar, edhe në Bashkinë Elbasan.

Paditësi, sikurse evidentuam edhe më lart, ka pretenduar se, pajisjet e përdorura ishin të programuara në mënyrë të tillë, që të dërgonin vota në favor të kandidatit të Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, Kodi Zgjedhor, ndërsa rregullon zbatimin pjesor të votimit elektronik, siguron edhe kushtet për të garantuar integritetin e pajisjeve kompjuterike nëpërmjet të cilave do të kryhet procesi i votimit dhe numërimit të votave. Mes këtyre garancive është edhe testimi parazgjedhor, që kryhet publikisht dhe që synon të shmangë përdorimin e pajisjeve, në rastet kur nga testimi evidentohen mangësi.

Në datë 04.05.2023, KQZ-ja rezulton të ketë kryer publikisht, testimin parazgjedhor të pajisjeve PEVN (Pajisjet Elektronike të Votimit dhe Numërimit).

Në rastin konkret, nuk rezulton të jenë konstatuar parregullsi të pajisjeve elektronike të votimit gjatë testimit parazgjedhor, ndërkohë që ligji obligon edhe një testim paszgjedhor.

Sikurse parashikojnë Nenet 22 dhe 23 të Kodit Zgjedhor, parregullsitë apo defektet që mund të konstatohen si gjatë testimit parazgjedhor, ashtu edhe gjatë atij paszgjedhor, mund të jenë edhe objekt i hetimit penal për kryerjen eventuale të veprave penale në fushën e zgjedhjeve.

Në rastin në shqyrtim, pretendimet e palës paditëse për programim të rezultatit të zgjedhjeve, mbeten vetëm në kuadër të dyshimeve, sikurse është edhe ai i një rezultati jo të pritshëm në qendra të caktuara votimi, që sipas ankuesit, tradicionalisht kanë votuar kandidatin e tyre. Përveç këtij dyshimi, pretendime të tilla si ai i vonës dhe mos përfundimit të procesit të votimit dhe urdhërimi i votuesve për tu larguar, mbetën të paprovuara.

Në këtë kontekst, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konfirmon përfundimin e KAS se:

“3. Pika 1, e nenit 82 të K.Pr.A saktëson: “në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej tij”. Këtë detyrim e vendos edhe Kodi Zgjedhor nëpërmjet shkronjës “b” të pikës 1, të nenit 136, kur u kërkon palëve “të tregojnë faktet dhe provat, mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre”.

4. Kodi Zgjedhor kërkon në mënyrë të shprehur që pretendimet të jenë të mbështetura në prova, sepse Kodi kërkon që t’i presë rrugën e suksesit kërkimeve të pathemelta ose me ves. Kjo do të thotë, se Kodi kërkon që raporti midis pretendimit dhe provës të jetë i drejtpërdrejtë, thënë ndryshe, prova duhet të shërbejë për të mbështetur drejtpërdrejt pretendimin. Pika 4 e nenit 136 të Kodit Zgjedhor saktëson, se “KQZ-ja mund të refuzojë kërkesën e ankuesit apo të palës së interesuar për marrjen e provave, sipas shkronjës “c” të pikës 1 dhe pikës 2 të këtij neni, vetëm

nëse vlerëson se prova nuk shërben për të vërtetuar faktet e pretenduara”. Nga ana tjetër, kjo do të thotë se në raportin midis provës dhe pretendimit, prova vjen e para. Provat ekzistojnë përpara pretendimit, nuk krijohen për shkak të tij...

10. KAS-i ka kërkuar që argumentet për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve të jenë konkrete, të faktueshme, të provueshme dhe të matshme...

11...Kolegji Zgjedhor çmon se nuk mjafton që të provosh se janë kryer shkelje që kanë cënuar procesin zgjedhor për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve, por duhet të provosh se “këto shkelje të jenë në një masë të tillë sa të mund të kenë ndikuar në ndarjen e mandatit...”.

Si përfundim, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor e gjen të paprovuar dhe si të tillë të pabazuar, pretendimin për paraprogramim të pajisjeve të votimit elektronik, duke mos konstatuar shkelje të kësaj natyre.

Në vijim të pretendimeve për votimin elektronik, pala paditëse parashit se pajisjet e përdorura për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023, nuk plotësojnë të gjitha kushtet e përcaktuara në aktin normativ, Vendimin Nr.4 Dt.13.11.2020 të Komisionit Rregullator (KRR) “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, me këtë akt normativ, KRR veç të tjerash ka vendosur që procesi i votimit dhe numërimit elektronik do të duhet të respektojë të njëjtat parime si në procesin manual si dhe të garantojë qartësi dhe lehtësi për votuesin (pika 4 e vendimit).

Në vijim, vendimi i mësipërm parashikon kushtet teknike, që duhet të plotësojnë PEVN, që konsistojnë së pari në sigurimin e votës në dy versione, atë elektronik dhe atë fizik, nëpërmjet printimit të zgjedhjes së secilit votues (pika 10, shkronja “c”), kushte që lidhen me sigurimin e integritetit fizik të pajisjeve dhe shmangien e ndërhyrjeve të paautorizuara, mbylljen e automatike të pajisjes pas çdo votimi, si dhe rihapjen e saj për votuesin e radhës etj.

Përveç sa më sipër, KRR parashikoi në shkronjën “k” të pikës 10 të vendimit, se “*Votuesit duhet t’i mundësohet verifikimi dhe konfirmimi i çdo zgjedhjeje të bërë, përfshirë dhe konfirmimin e verifikimit të versionit fizik të votës, si dhe kutia të mundësojë për aq sa është e mundur, fotografimin e votës*”.

Ky parashikim nënkupton mundësinë e votuesit për të anuluar votimin e tij, pasi ka parë versionin fizik të votës (atë të printuar) dhe kupton se nuk përkon me zgjedhjen e tij, apo kur ka gabuar në përdorimin e pajisjes.

Në rastin e PEVN-ve të përdorura për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023, ndryshe nga ato për Kuvendin të vitit 2021, kjo mundësi nuk ofrohet nga pajisja, çka përbën, sipas palës paditëse, edhe shkak të mjaftueshëm për pavlefshmërinë e zgjedhjeve vendore në Bashkinë Elbasan.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, përfaqësuesja teknike e KQZ-së sqaroi në seancë gjyqësore faktin se, për shkak të natyrës së procesit për zgjedhjet vendore në të cilin duhej të përdreshin dy fletë votimi, ndryshe nga zgjedhjet për Kuvendin, teknikisht ishte e pamundur që të programohej pajisja elektronike e votimit me opsionin e konfirmimit/ndryshimit të votës pas

përfundimit të procedurës. Në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2021 kjo mundësi ka ekzistuar, por sipas saj, përdorimi i dy fletëve të votimit në zgjedhjet vendore (atë për kryetar bashkie dhe atë për këshillin bashkiak), e bënte të pamundur teknikisht për ta pasur si mundësi konfirmimin fizik të votës.

Lidhur me këtë çështje, Kolegji Zgjedhor konstaton se, pajisjet elektronike të votimit të përdorura në zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023, nuk e plotësonin një prej kushteve teknike të përcaktuara në aktin normativ të KRR, që lidhet pikërisht me mundësinë e anulimit të votës fizike (pas printimit nga pajisja). Kjo do të thotë se pavarësisht mundësisë për konfirmimin elektronik të votës, zgjedhës të caktuar, që eventalisht mund të kenë gabuar në përdorimin e pajisjes elektronike të votimit, të mos kenë pasur mundësi të përsërisin procesin, pas printimit të votës fizike.

Me konstatimin e faktit të shkeljes së rregullave të caktuara për votimin elektronik, dhe në kontekstin e vlerësimit të faktit nëse shkelja ka qënë e tillë që ka ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve për Bashkinë Elbasan, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konfirmon përfundimet e KAS se:

“12. Ankuesi pretendoi në seancë, se të paktën në 6 QV ka ndodhur tjetërsim i votës nga regjistrimi i votës në PEVN, tek depozitimi i votës fizike në kuti. Këto raste përfshinin 4 denoncime nga votues të ndryshëm (QV nr.2373/01, QV nr.2377, QV nr.2358 dhe QV nr.2477), sipas të cilave ata kishin lexuar në votën fizike të printuar emrin e kandidatit që nuk kishin votuar dhe një pretendim, se rezultati i kutive për dy QV të KZAZ-së nr.47 nuk kuadronte me rezultatin e transmetuar nga pajisja PEVN, gjë që kishte qënë objekt debati midis KZAZ-së dhe administratës së KQZ-së (QV nr.2481/01 dhe QV nr.2483). Mbi këtë bazë, ankuesi kërkoi hapjen dhe numërimin e votave fizike për këto 6 QV, me pretendimin se rezultati i numërimit të votave fizike do të dilte i ndryshëm nga ai elektronik dhe do provonte vërtetësinë e denoncimeve. KAS-i pranoi për këqyrje dhe numërim të votave fizike QV nr.2373/01, QV nr.2481/01 dhe QV nr.2483, për shkak se për QV nr.2373/01 denoncimi ishte bërë publikisht dhe ishte i vërtetueshëm, kurse për dy QV-të e tjera për shkak se pretendimi u konfirmua edhe nga administrata e KQZ-së, por me arsyetimin se debati kishte pasur lidhje jo me transmetimin e shifrave të ndryshme, por me regjistrimin e shifrës zero, të cilën sistemi e merr sa herë që nuk arrin të lexojë USB. Për tre QV-të e tjera, pretendimi ishte i paverifikueshëm. Këqyrja dhe numërimi i votave fizike për 3 QV-të u krye në seancën e datës 05.06.2023. Rezultati provoi përputhjen e plotë të numrit dhe vlerësimit të votave fizike me përmbledhësen e votimit elektronik, duke rrëzuar pretendimin e ankuesit.

13. Ankuesi pretendoi se në KZAZ-në nr.47 ishin marrë në dorëzim kutitë e 76 QV-ve në kushte parregullsie (pa vula sigurie), gjë që ishte pasqyruar edhe në librin e protokollit të KZAZ-së. Në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së u gjet vetëm shënimi se “çdo parregullsi apo mungesë është pasqyruar në procesverbalet përkatëse”. Mbi këtë bazë, KAS-i i kërkoi administratës së KQZ-së që t'i vinte në dispozicion ankuesit procesverbalet e dorëzimit të materialeve të votimit dhe numërimit elektronik nga KQV në KZAZ, për gjithë ZAZ-në. Pas marrjes së provës, në seancën e datës 05.06.2023, ankuesi ngriti pretendimin se kutitë e 30 QV-ve ishin marrë në dorëzim me parregullsi të theksuara, të specifikuara për secilën prej tyre. KAS-i i kërkoi administratës së KQZ-së që të mbante qëndrim për këtë konstatim. Në seancën e datës 07.06.2023 administrata raportoi gjendjen faktike, si vijon: - 5 kuti pa kod sigurie në kutinë e materialeve zgjedhore; - 7 kuti të rregullta; - 12 kuti të papërdorura; - 4 kuti pa kodin e sigurisë të printerit; - 1 PEVN pa kod sigurie të USB-së; - 1 QV e përfshirë në listë si me probleme, nuk ekziston në këtë ZAZ. Ankuesi kontestoi raportimin për 2 QV, për QV-në nr.2379 dhe për QV-në nr.2446. Mbi këtë

bazë, KAS-i vendosi këqyrjen e materialit zgjedhor për këto dy QV. Këqyrja e jashtme e kutive konfirmoi të dhënat e procesverbalit të marrjes në dorëzim, kurse këqyrja e fletëve fizike të votimit konfirmoi rezultatin e pasqyruar në tabelën përmbledhëse. Për QV-në nr.2446 u konstatua diferencë midis numrit të zgjedhësve të prodhuar nga pajisja PEI (132 zgjedhës) me numrin e zgjedhësve të prodhuar nga përmbledhësja e pajisjes PEVN (133 zgjedhës). Administartara e KQZ-së informoi në seancë, se sipas hetimit të kryer prej saj, diferenca me shifrën 1 vinte për shkak të votimit të operatorit, pa u regjistruar nga pajisja PEI.

14. “Rregullat procedurale teknike për procesin e votimit elektronik nëpërmjet pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik në Bashkitë Vorë, Kamëz dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, që janë miratuar me vendimin e Komisionerit nr. 415, datë 26.04.2023 përcaktojnë, se si bëhet deklarimi “kuti e parregullt” ose “PEVN e parregullt”. Mungesa e kodit të sigurisë të printerit apo e kodit të sigurisë së USB-së, janë përcaktuar në këtë dokument si shkak për deklarimin “kuti e parregullt”, përkatësisht “PEVN e parregullt”. Tetë kutitë dhe 2 PEVN-të që shfaqën këtë problematikë (QV nr. 2394/01, QV nr. 2457, QV nr. 2476/01, QV nr. 2480, QV nr. 2422/01) janë marrë në dorëzim si të rregullta. Ankuesi nuk lidhi asnjë pretendim dhe asnjë kërkim me këtë fakt.

16. Ankuesi pretendoi se operimi në kushte paligjshmërie i pajisjes ka eliminuar një nga garancitë e procesit zgjedhor, që është e drejta e zgjedhësit për të modifikuar në çdo kohë vullnetin, deri në momentin e hedhjes së votës në kutinë e votimit, si dhe ka krijuar pabarazi midis votuesve me votim elektronik dhe atyre me votim manual...

18. Që KAS-i të vendosë pavlefshmërinë e zgjedhjeve, për shkakun e mësipërm, duhet që ankuesi të provojë se zgjedhësve u është hequr një garanci ligjore, e cila ka kondicionuar masivisht sjelljen e votuesve dhe i ka penguar masivisht në ushtrimin e lirë të vullnetit të tyre. Ankuesi duhet të provonte, se e drejta për të korigjuar shprehjen e vullnetit, sa kohë që nuk është mbyllur procedura e votimit, është e drejtë e cila përdoret masivisht në zgjedhje, se ajo është vijë sjelljeje e votuesve shqiptarë dhe se provohet si e tillë nga statistika zgjedhore dhe numri i lartë i votave të dëmtuara, në rastet e votimit manual. Ky do ishte korrelacioni që kërkon Kodi dhe jurisprudenca zgjedhore midis shkeljes së sipërcituar dhe pasojës që çon në pavlefshmëri zgjedhjesh. Ankuesi nuk e prezantoi para KAS-it një provë të tillë, ndoshta për shkak të faktit se praktika zgjedhore shqiptare nuk ia jep këtë mundësi.

19. Pretendimi për cënim të barazisë midis votuesve me votim elektronik dhe me votim manual, për shkak të kësaj diferencë nuk formon dot shkak për pavlefshmëri zgjedhjesh...”.

Si konkluzion, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se, kërkitimi i palës paditëse për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në Bashkinë Elbasan, për shkak të shkeljeve në votimin elektronik, është i pabazuar në ligj, pasi nuk u arrit të vërtetohet se mosplotësimi i njërit prej kushteve teknike të PEVN, cenoi procesin zgjedhor dhe aq më tepër nuk u provua që kjo shkelje të ketë qenë e tillë, sa të ketë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve.

Lidhur me shkeljet e tjera

Referuar procesit të votimit, pala paditëse parashtroi edhe pretendime të tjera që lidhen me shkelje, që sipas saj, kanë ndodhur në qendrat e votimit, apo akte të tjera që kanë ndikuar në vullnetin e zgjedhësve.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konstaton të qenurit e tyre pretendime të përgjithshme, të bazuara në perceptimet subjektive të ankuesit, apo edhe të mbështetura në fakte të paprovuara.

Në vijim pasqyrohet secili pretendim, si dhe vlerësimi i Kolegjit Zgjedhor.

Nuk provohet pretendimi i palës paditëse se, operatorët në masë ishin familjarë të punonjësve të administratës dhe të kryetarëve të organizatave të Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Nuk provohet nga paditësi, masiviteti i pretenduar për shoqërimin e votuesve nga ana e Komisionerëve, Operatorëve të QV-ve, punonjësve të administratës vendore e qendrore, apo fakti që këta persona të kenë votuar në emër të zgjedhësve.

Pala paditëse nuk arriti në gjykim të vërtetojë se, operatorët e sistemit që asistojnë në përdorimi e PEVN, kanë votuar për llogari të tjerëve.

Nuk u provua blerja masive e votës.

I papërligjur në raport me rrethanat për pavlefshmëri të zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre, rezultoi edhe pretendimi për shkelje të fshehtësisë së votës.

Njëjtë vlerësohet edhe pretendimi se, disa ditë para zgjedhjeve punonjës të ASHK, shkonin shtëpi në shtëpi për të ofruar legalizimin në këmbim të votës.

Pretendimi për përdorim të bizneseve VIP apo për kryerje të punëve publike pa procedura prokurimi, referon në shkelje të normave për financimin e fushatës së zgjedhjeve, për të cilat ndiqet procedura e caktuar në Kodin Zgjedhor.

Nuk rezulton që shkelje të tilla t'i jenë referuar KQZ-së përgjatë fushatës zgjedhore.

Pretendimi për ndryshimin e qendrave të votimit pa asnjë arsye për një numër të madh zgjedhësish krahasuar me zgjedhjet pararendëse, mbeti thjesht deklarativ dhe nuk u konkretizua.

Në çdo rast, lista e zgjedhësve, hartimi i saj dhe aksesimi i çdokujt në të, garantohej nga Kodi Zgjedhor dhe i përket fazës parazgjedhore, në të cilën do të duhej të ishte adresuar çdo lloj shqetësimi në këtë drejtim.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konfirmon në këtë kontekst, përfundimet e KAS se:

“22. KAS-i çmon se një gjysëm duzine rastesh të votimit familjar, një numër rastesh parregullsisht në zbatimin e procedurës së votimit të asistuar, një numër i kufizuar shkeljesh në asistimin e më shumë se të një personi, ose në asistimin e votuesve nga komisionerët, nuk formojnë dot masë kritike për të deklaruar pavlefshmërinë e zgjedhjeve as në qendrat respektive, as në gjithë zonën zgjedhore.

23. Të gjitha shkeljet e identifikuar nga provat video janë shkelje që ndiqen individualisht në kuadër të hetimit penal (neni 327 i Kodit Penal “Shkelja e fshehtësisë së votimit”) ose të hetimit të denoncimeve me karakter administrativ. Si episode shkeljesh, në kuadër të shqyrtimit të kërkesës për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonën zgjedhore, ato nuk plotësojnë kushtin e masës kritike që kërkon neni 160 i Kodit Zgjedhor dhe jurisprudenca zgjedhore.

24. Sa i takon pretendimeve për ushtrimin e detyrës së komisionerit apo operatorit në kushtet e papajtueshmërisë, apo të përdorimit të punonjësve të administratës ditën e zgjedhjeve

pranë qendrave të votimit për të intimiduar ose shoqëruar zgjedhës të caktuar, ankuesi nuk solli prova për të faktuar pretendimin, apo për të faktuar se ishin zbatuar pa sukses procedurat mbrojtëse që parashikon ligji në këto raste, sikurse nuk solli prova lidhur me masën e ndikimit të secilit prej rasteve të denoncuara në mbarëvajtjen e zgjedhjeve”.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor tërheq vëmendjen e paditësit mbi faktin se, pala paditëse nuk ka vërtetuar para KAS dhe nuk vërtetoi as në seancë gjyqësore, ekzistencën gjatë procesit zgjedhor në Bashkinë Elbasan, të rrethanave të evidentuara në Vendimin Nr.169 Dt.26.07.2002 të Gjykata Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, nëpërjet këtij vendimi, evidentohet dhe konkludohet se:

“Në zgjedhjet e pjesshme të datës 07.07.2002, Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.19, ka shpallur fitues kandidatën e Partisë Socialiste, Ardit Kaja, me 6579 vota pro (50.57 % të votave të vlefshme) kundrejt 5761 të votave të hedhura në favor të kërkuarit Gafur Muka, kandidat i subjektit elektorale PD+BF.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.54, datë 10.07.2002, ka rrëzuar si të pambështetur në ligj, kërkesën ankimore të kërkuarit Gafur Muka.

Si kërkuari Gafur Muka ashtu edhe Partia Konservatore e Shqipërisë, i reduktuan kërkesat gjatë gjykimit në pavlefshmërinë e zgjedhjeve në të njëjtat qendra votimi.

Gjatë shqyrtimit të çështjes në Gjykatën Kushtetuese, doli se komisionet e qendrave të votimit nr.19, 21, 22, 27 e 41 të zonës nr.19 të zgjedhjeve, kanë lejuar shkelje të Kushtetutës dhe të ligjit, shkelje që konsiston në votimin e një personi në emër të familjarëve. Kjo i bën zgjedhjet të pavlefshme, në kuptim të nenit 113/1 të Kodit Zgjedhor.

Megjithëse komisionerët e qendrave të votimit dhe të Zonës Zgjedhore nuk kanë pasqyruar në tabelat e rezultateve vërejtjet për këtë shkelje ligji, kërkuari Gafur Muka, paraqiti në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe në Gjykatën Kushtetuese vendimin nr.10, datë 08.07.2002, të Komisionit të Zonës Zgjedhore, duke kërkuar shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në ato qendra. Ekzistenca e këtij vendimi nuk është kontestuar nga palët dhe për më tepër, pakica prej tre anëtarësh ka pasqyruar në të mendimin e vet.

Kërkuari paraqiti gjithashtu një procesverbal të Komisionit të Qendrës së Votimit nr.19 Boçevë, të mbajtur ditën e votimit, në të cilin 6 nga 7 anëtarët e Komisionit kanë pranuar të “votohet edhe për anëtarë të familjes, përjashtuar emigrantët”.

Gjykata Kushtetuese administroi si prova listat e zgjedhësve të përdorura gjatë votimit, të cilat kanë vlerë vendimtare provuese për çështjen. Kjo Gjykatë konstatoi se në një shumicë rastesh dhe në mënyrë të dukshme kishte nënshkrime të njëjta për votues të një familje, gjë që bën bindës pretendimin e kërkuarit se ka votuar një person edhe për anëtarët e tjerë të familjes. Votimi i një personi për të tjerët çënon parimin e votës vetiake, parashikuar në nenin 45/4 të Kushtetutës. Si Kushtetuta edhe nenet 6 e 98/1 të Kodit Zgjedhor, mbajnë qëndrim rigoroz kundër çdo shkelje të këtij parimi dhe përcaktojnë rregulla të detajuara për të shmangur çënimin e kësaj të drejte politike. Çdo shmangie prej tyre të çon në pasoja për gjithë procesin zgjedhor.

Nga gjykimi i çështjes rezultoi se komisionet e lartpërmendura të qendrave të votimit, në kundërshtim me ligjin, kanë lejuar me marrëveshje të komisionerëve, që zgjedhësit të votojnë në emër të familjarëve të tyre. Jo vetëm kaq, por Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka bërë verifikime e nuk ka mbajtur qëndrim ndaj kësaj shkelje të rëndë të ligjit, aq në tepër që ishin

mundësitë sepse listat e zgjedhësve ndodheshin jashtë kutive të votimit, siç e pohon vetë ky komision në shkresën nr.666/2, datë 25.07.2002 që i ka dërguar Gjykatës Kushtetuese.

Duke marrë parasysh rezultatet e zgjedhjeve në atë zonë dhe sidomos numrin e votave që kanë marrë kandidatët për deputetë të subjekteve elektorale PS e PD+BF, del se shkeljet e mësipërme kanë lidhje të drejtpërdrejtë me rezultatin përfundimtar në zonë dhe kanë ndikuar në fitimin e mandatit ose në moskalimin në raundin e dytë të zgjedhjeve”.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konfirmon në këtë kontekst, përfundimet e KAS se:

“21. Ankuesi solli në vëmendje të KAS-it vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.169, datë 26.07.2002, në mbështetje të pretendimit se votimi familjar është shkak pavlefshmërie i njohur dhe pranuar nga Gjykata Kushtetues. KAS-i sjell në kujtesë faktin se Gjykata Kushtetuese atëkohë ka vepruar si gjykatë e posaçme për shqyrtimin e konflikteve zgjedhore, d.m.th. si Kolegji Zgjedhor Gjyqësor sot. Rasti i gjykuar në atë kohë mund të përdoret si ilustrim për interpretimin që i bën KAS-i pavlefshmërisë së zgjedhjeve. Baza e gjykimit në rastin e vitit 2002 ishte shkelja e ligjit nga KQVe të me vendim dhe pranimi nga KQV-të, si votim i rregullt, i praktikës së votimit familjar në masë. Ky është rasti kur një shkelje e vetme (vendimi i kundraligjshëm i KQV-së) mund të formojë shkak të vetmjaftueshëm për pavlefshmëri. Rasti i paraqitur nga ankuesi është i ndryshëm nga rasti i gjykuar nga Gjykata Kushtetuese në vitin 2002. Ankuesi paraqiti prova për një gjysëm duzine episodesh të votimit familjar në QV-në e fshatit Labinot Mal. Prova tregonte gjithashtu një komisioner, i cili, të paktën në njerin nga këto raste, ndërhynte për të penguar veprimin e kundërligjshëm. Episodet e denoncuara në QV-të e tjera bëjnë fjalë për votim të asistuar, i cili në vetvete është votim i ligjshëm, por duhet dokumentuar sipas një procedure të caktuar. Në këtë rast, moskryerja e procedurës duhet të cilësohet ligjërisht si parregullsi në administrim”.

Për sa më sipër, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se, pala paditëse, ndonëse ka evidentuar shkelje të ligjit, një pjesë e të cilave edhe nga KAS është pranuar se kanë ndodhur, nuk arriti të vërtetonte se shkeljet ishin të tilla, që të kushtëzonin rezultatin e zgjedhjeve.

Shkeljet e ligjit që passjellin pavlefshmërinë e zgjedhjeve, sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor, duhet të jenë të tilla që të kenë ndikuar në rezultatin përfundimtar.

Thënë ndryshe, në rastin në shqyrtim duhej të provohej se, pa shkeljet e evidentuara dhe të provuara, rezultati i zgjedhjeve nuk do të ishte i njëjtë.

Kjo kërkesë e Kodit Zgjedhor, që e cilëson rezultatin pasojë të drejtpërdrejtë të shkeljeve të ligjit, mbetet kushti, pa të cilin një proces zgjedhor nuk mund të zhbëhet, pavarësisht se provohet se një apo më shumë subjekte kanë kryer shkelje të Kodit Zgjedhor.

Përfundimisht, kërkespadia vlerësohet e pabazuar ne ligj e prova.

Shpenzimet gjyqësore lidhur me këtë çështje përbëhen nga taksa mbi aktet ne masën 30000 lëkë, parapaguar nga paditësi. Shpenzime të tjera nuk u kryen dhe as u pretenduan.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në Nenin 158/1,c/3 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, unanimisht:

VENDOSI

- Rrëzimin e kerkesëpadiësë.
- Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palës paditëse.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall sot në Tiranë, në datë 20.06.2023.

GJYQTARE Esmeralda XHILI	GJYQTARE Emona MUÇI	GJYQTARE Manjola XHAXHO	GJYQTARE Alma KOLGJOKA	GJYQTARE Blerona HASA
------------------------------------	-------------------------------	-----------------------------------	----------------------------------	---------------------------------